



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari i Komunës



RAPORT
PËR SITUATEN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E PLANEVE
INVESTUESE SI DHE I PUNËS SE KRYETARIT TE KOMUNES – EKZEKUTIVIT PËR
VITIN 2014

Mars 2015

Përmbajtja

Hyrje.....	2
Buxhet dhe financa.....	3
Ekonomi, bujqësi, pylltari.....	8
Prokurimi.....	12
Shërbime publike.....	21
Urbanizëm dhe mbrojtje e mjedisit.....	22
Administratë.....	23
Arsimi.....	26
Shëndetësia.....	31
Mbrojtje dhe shpëtim.....	37
Inspektimet.....	39
Kulturë, rini dhe sport	42
Gjeodezi, kadastër dhe pronë.....	46
Zyra për integritet evropian	47
Njësia e personelit.....	47
Zyra për komunikim me publikun.....	48
Sekretaria e kuvendit.....	49
Njësia e auditimit të brendshëm.....	49
Zyra ligjore.....	51
Zyra lokale e komuniteteve	51
Këshilli komunal për siguri në bashkësi.....	52

Hyrje

Në këtë raport është paraqitur situata ekonomike dhe financiare, realizimi i planeve investuese të komunës, si dhe puna dhe aktivitetet e Kryetarit të komunës, përkatësisht ekzekutivit të komunës, në përmbushjen e detyrave nga fushëveprimtaria dhe kompetencat e tyre të përcaktuara me ligj dhe akte tjera nënligjore.

Aktivitetet kryesore të Kryetarit të Komunës gjatë vitit 2014:

- Angazhimet ditore – koordinimi i punëve me drejtorë të drejtorive në bazë të dinamikës, detyrave dhe punëve ditore për kryerje sa më efikase të tyre;
- Mbatja e takimeve të rregullta javore me drejtorë të drejtorive, përcaktimi i detyrave javore dhe raportimi për detyrat që janë kryer në baza javore;
- Takimet e kohëpaskoshme me palë;
- Takimet me qytetarë në tubime të ndryshme duke përfshirë dy takimet obligative të parapara me ligj (njëra në 6 mujorin e parë dhe takimi tjetër në 6 mujorin e dytë);
- Takimet e ndryshme me zyrtarë në nivel të komunës dhe nivel qendror, institucionalë dhe jashtëinstitucionalë (shoqëria civile, etj.);
- Takimet me përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare, vendore dhe ndërkombëtare;
- Takimet me përfaqësues të OSBE, Policisë së Kosovës, FSK- së, KFOR-it etj;
- Mbledhjet e rregullta me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Takimet me grupet e ndryshme të komuniteteve, pastaj,

- Propozimet për shqyrtim të materialeve për mbledhje të Kuvendit të Komunës;
- Pjesëmarrje në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës;
- Mbikëqyrje në zbatimin e rregulloreve dhe vendimeve të miratuara në Kuvendin e Komunës;
- Mbikëqyrje e realizimit të buxhetit të komunës për vitin fiskal dhe realizimin e të hyrave vetanake;
- Mbikëqyrje e realizimit të projekteve kapitale të komunës, etj.
- Bashkëpunim me komunitetin për realizim të projekteve të ndryshme;
- Bashkëpunim me institucionet qendrore për realizim të projekteve me interes për komunën dhe qytetarët;
- Bashkëpunim me shoqatat e dala nga lufta, Shoqatën e të burgosurve politikë dhe shoqata tjera,
- Mbikëqyrje në ngritjen e performancës në administratën e komunës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për qytetarë.

Gjithashtu, Kryetari i komunës brenda vitit raportues ka nxjerrë 26 urdhëresa; 461 vendime; 29 autorizime; ka nënshkruar 20 kontrata mbi qiranë për 20 familje të pastrehë; ka pranuar 32 raporte të ndryshme dhe 14 plane të punës nga drejtoritë komunale; komisionet e ndryshme; auditorët etj. Po ashtu ka pranuar 27 shkresa

nga institucionet qendrore, ndërsa i ka dërguar në këto institucione 30 shkresa për çështje të ndryshme; ka pranuar 37 njoftime, gjegjësisht informata të ndryshme me shkrim; shkresa tjera (procesverbale, formularë aplikimi, pëlqime, propozime, rekomandime etj.), si dhe shkresa tjera nga: ndërmarrjet publike, shoqëria civile, organizata dhe shoqata të ndryshme, organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, individë – nëpunës civil dhe qytetarë, të evidentuara në protokollin e Zyrës së kryetarit, etj., të cilat janë shqyrtuar dhe proceduar apo vendosur konform legjislacionit të zbatueshëm - **627**.

Kryetari i komunës ka nënshkruar po ashtu këto marrëveshje mirëkuptimi:

- Marrëveshje me IMO për rregullimin e varrezave të shqiptarëve dhe të gjitha komuniteteve tjera.
- Marrëveshje për bashkëpunim me “IADK” Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës.
- Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe **REA Prishtina**.
- Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës, mbi bashkëpunimin në vendosjen e adresave në territorin e komunës.
- Marrëveshje Bashkëpunimi për qëllime humanitare “Time To Help” nga Gjermania dhe Komuna Vushtri.
- Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe REC-it.
- Memorandum Mirëkuptimi në mes të Komunës së Vushtrrisë, Zyra e BE-së, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, IOM.
- Marrëveshje Mirëkuptimi për bashkëfinancim me projekte në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Ambasadës së Turqisë në Kosovë.
- Marrëveshje Mirëkuptimi për realizim të projektit të përbashkët me Organizatën për Zhvillim Rural “Mëshqerra” (furnizim me krerë dhi).
- Marrëveshje Bashkëpunimi dhe - **MKEF**, Islam Islami – Suedi për aplikim në fondet e Bashkimit Evropian.
- Memorandum Mirëkuptimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës për sistemin e adresave.
- Marrëveshje Partecipimi në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe përfituesve të makinave mjelëse.
- Memorandum Mirëkuptimi në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe **Organizatës IOM** renovimi i shkollës në Stanoc.
- Marrëveshje me **FODEM** për aplikim dhe zbatim të projektit të përbashkët “Komiteti joshumicë në vendimmarrje”.
- Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe **REC- Zyra** në Prishtinë.
- Marrëveshje e Mirëkuptimit me Lux Development (nga Luksemburgu) me Komunën e Vushtrrisë për ndërrimin e rrjetit të ujësjellësit (Faza II).
- Marrëveshje Mirëkuptimi me Zyrën e Bashkimit Evropian, mbledhja dhe paketimi i mbeturinave të riciklueshme në Vushtri (letër dhe plastikë).
- Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe CHwB, për financim të projektit “Pasurimi i Bibliotekës së Muzeut të Vushtrrisë me literaturë mbi trashëgiminë kulturore nga vendi dhe regjioni”.

Në vijim të këtij raporti do të pasqyrojmë në mënyrë të detajuar punët që janë kryer brenda vitit 2014, nga kryetari – qeveria komunale (realizimi i investimeve, realizimi i buxhetit, si dhe punët dhe aktivitetet tjera sipas resorëve).

Buxhet dhe financa

Planifikimi i buxhetit për vitin 2014 është si në vijim

- Paga dhe mëditje..... 8,593,969.81€

- Mallra dhe shërbime..... 1,366,668.41€
- Shpenzime komunale..... 196,529.00€
- Subvencione dhe transfero..... 247,555.76 €
- Investime kapitale..... 4,369,265.71€

Totali i buxhetit për vitin 2014 14.773,988.69 €

Forma tabelare: Buxheti i planifikuar dhe shpenzimet e realizuara

Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese (Janar-Dhjetor 2014)		
		Buxheti i planifikuar për PR	Shpenzimet e realizuara në PR	Përqindja e buxhetit të realizuar për PR
		4	5	6 = 5/4*100
		€	€	%
Paga dhe mëditje	111	8,593,969.81	8,497,772.64	99%
Mallra dhe shërbime	130	1,366,668.41	1,204,038.48	88%
Shpenzimet komunale	132	196,529.00	194,143.99	99%
Subvencionet dhe transferet	200	247,555.76	242,980.00	98%
Investimet kapitale	300	4,369,265.71	3,964,919.49	91%
TOTALI		14,773,988.69	14,103,854.60	95%

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE

Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese (PR)		
		Buxheti i planifikuar për PR	Shpenzimet e realizuara në PR	Përqindja e buxhetit të realizuar për PR
		€	€	%
Zyra e Kryetarit	160	247,555.53	239,309.55	97%
Administrata dhe personeli	163	261,433.51	259,703.13	99%
Inspektimet	166	98,861.41	95,659.74	97%

Prokurimi	167	30,992.33	28,973.93	93%
Zyra e Kuvendit Komunal	169	124,127.00	120,871.04	97%
Buxheti dhe financat	175	167,532.36	167,071.54	100%
Shërbimet publike, Mbrojtja civile dhe emergjenca	180	1,574,439.89	1,418,577.17	90%
Zyra lokale e komuniteteve	195	42,194.90	41,657.17	99%
Bujqësi, pylltari, zhvillim rural	470	260,004.74	258,092.22	99%
Gjeodezi dhe kadastër	650	161,198.87	161,160.98	100%
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	2,555,541.59	2,481,354.40	97%
Shëndetësia primare	730	1,895,617.91	1,872,626.95	99%
Shërbimet sociale rezidenciale		78,355.20	78,158.68	100%
Kulturë, rini, sport	850	319,621.74	298,974.98	94%
Arsimi	920	6,610,776.17	6,581,663.12	100%
TOTALI		14,428,253.15	14,103,854.60	98%

Realizimi i buxhetit për periudhën janar – dhjetor/2014

- Paga dhe mëditje 8,497,772.64€
- Mallra dhe shërbime..... 1,204,038.48€
- Shpenzime komunale..... 194,143.99€
- Subvencione dhe transfero..... 242,980.00€
- Investime kapitale..... 3,964,919.49€

Totali i shpenzimeve.....14,103,854.60 €

Realizimi i shpenzimev..... ..95 %

Planifikimi i të hyrave për periudhën janar – dhjetor/2014

1 2	Komuna Vushtrri	Planifikimi mujor	Realizimi	Realizimi		
		Janar-Dhjetor	Janar-Dhjetor	Janar-Dhjetor	%	%
	644	2014	2013	2014		
	Përshkr.	2014	2013	2014		

	N / R		1	2	3	3:1	3:2
Admini- strata	1	Admin.	86,000.0 0	66,205. 40	71,725. 44	83.40	108.3 4
	2	Ndërrim i emrit, mbiemrit		2,424.0 0	1,440.0 0	#DIV /0!	59.41
Totali		Administratë	86,000.0 0	68,629. 40	73,165. 44	85.08	106.6 1
Buxheti	3	Qiraja		2,804.0 0		#DIV /0!	-
	4	Taksat e firmave	160,000. 00	122,709 .18	146,548 .04	91.59	119.4 3
	5	Tatimi në pronë	380,000. 00	335,753 .14	446,087 .32	117.3 9	132.8 6
	6	Transaksioni	27,000.0 0	27,092. 00	25,022. 10	92.67	92.36
Totali		Buxhet	567,000. 00	488,358 .32	617,657 .46	108.9 3	126.4 8
Arsimi	7	Shitja e produkteve bujqësore		1,377.9 9	1,519.6 0	#DIV /0!	110.2 8
	8	Participim në çerdhen e fëmijëve	40,000.0 0	40,532. 00	39,070. 00	97.68	96.39
	9	Shkolla SHMT	17,500.0 0	11,865. 00	22,082. 00	126.1 8	186.1 1
	10	Shkolla SHMP	18,438.0 0	16,721. 00	14,445. 00	78.34	86.39
Totali		Arsimi	75,938.0 0	70,495. 99	77,116. 60	101.5 5	109.3 9
Gjeo- dezi, Kada- stër, Pronë	11	Hipoteka		14,940. 00	9,477.0 0	#DIV /0!	63.43
	12	RDPP	52,000.0 0	26,760. 00	56,068. 91	107.8 2	209.5 3
	13	Dalja në terren		23,394. 50	12,870. 55	#DIV /0!	55.02
	14	Lista poseduese		18,623. 00		#DIV /0!	-

	15	Kopje plani		3,196.00		#DIV /0!	-
	16	Vërtetime të ndryshme	22,000.00	2,351.00	27,691.00	125.87	1,177.84
Totali		Gjeodezi, Kadastër	74,000.00	89,264.50	106,107.46	143.39	118.87
Kulturë, Rini, Sport	17	Palestra sportive	5,000.00	3,859.00	2,799.50	55.99	72.54
	18	Biblioteka: Maxhunaj, Lumkuq, Krasniqe, Smrekonicë, Pantinë dhe Shtruherë	2,000.00	1,471.00	1,689.50	84.48	114.85
	19	Shtëpia e Kulturës	1,500.00	443.90	320.50	21.37	72.20
Totali		Kulturë	8,500.00	5,773.90	4,809.50	56.58	83.30
Shërbime publike	20	Ndalja e veturave në rrugë	8,100.00	1,841.50	965.80	11.92	52.45
		Provizioni i merimangës			1,176.55		#DIV /0!
	21	Taksa rrugore	95,000.00	100,141.50	96,760.50	101.85	96.62
Totali		Shërbimet Publike	103,100.00	101,983.00	98,902.85	95.93	96.98
Prokuri-mi	22	Tender		18,402.70		#DIV /0!	-
Ekonomi	23	Ndërrimi i tokës bujqësore	36,130.00	2,239.30	20,228.25	55.99	903.33
	24	Qiraja e tokës	25,000.00	2,949.00	2,109.75	8.44	71.54
Totali		Ekonomi	61,130.00	5,188.30	22,338.00	36.54	430.55
Totali	25	Participim në Drejtorinë e Shëndetësisë	50,932.00	42,015.50	43,526.50	85.46	114.46
		Qendra për Punë Sociale			1,685.00	#DIV /0!	40.68
		Shëndetësi	50,932.00	42,015.50	45,211.50	88.77	107.61
	26	Donacion	145,000.00	38,028.00	381,885.00	263.30	1,004.00

			00	00	.54	7	.22
Drjejtoria e Inspektiveve	27	Pranimet teknike		4,142.50	5,145.00	#DIV/0!	123.49
	28	Pëlqimet sanitare		4,166.37	7,402.39	#DIV/0!	177.67
	29	Gjobat e inspektiveve	10,000.00	740.00	280.00	2.80	37.84
Totali		Inspeksioni	10,000.00	9,048.87	12,827.39	128.27	128.27
Urbanizmi	30	Leje urbanistike		1,215.00		#DIV/0!	-
	31	Leje ndërtimi	258,000.00	182,716.22	136,462.61	52.89	74.69
	32	Shf. Prko.pro. Shoq	42,400.00	31,306.05	40,927.65	96.53	130.73
Totali		Urbanizmi	300,400.00	215,237.27	177,390.26	59.05	82.42
	33	Dënimet e policisë	40,000.00	20,546.00	53,383.00	133.46	259.82
	34	Dënimet e gjykatës	130,000.00	74,620.00	76,910.00		103.07
	35	Të hyrat tjera		959.08	3,888.11		
Totali			1,652,000.00	1,248,550.83	1,751,593.11	106.03	140.29

Planifikimi1,652,000.00€

Realizimi1,751,593.11€

Shprehur në %140.29

Krahasuar me vitin 2013, realizimi në vitin 2014 është për 40.29%, më i madh.

Ekonomi, bujqësi, pylltari

Gjatë këtij viti, në këtë sektor synim ka qenë edhe thjeshtimi i procedurave për regjistrimin e bizneseve: Edhe ky objektivi është realizuar sepse tani këto procedurat janë thjeshtuar dhe aplikimi për hapje të një biznesi të ri bëhet vetëm me letërnjoftim.

Synimi për përmisimin e klimës për të bërë biznes në komunë është realizuar pothuajse në tërësi, sepse nuk ekzistojnë kurrfarë barrierash administrative dhe të taksave për të filluar biznesin në komunën tonë.

Qendra komunale e biznesit, shërbimin ndaj komunitetit të biznesit, për të gjithë ata që janë të përfshirë në biznes do ta bëjë sa më të lehtë duke i kryer të gjitha llojet e nevojave për biznesin e tyre në një zyrë. Duke shfrytëzuar mundësitë që ofron teknologjia informative (IT) dhe duke u bazuar në performancën e stafit

profesional të QKB-ës, në fund të vitit 2014 ARBK ka instaluar edhe një program të ri në softver dhe i cili do të jetë i aplikueshëm nëpër komuna gjatë vitit 2015. Ky program në vete përmban të dhëna të përpunuara dhe të detajuara për çdo biznes të regjistruar në ARBK. Në këtë përfshihen edhe nomenklatura e re e bizneseve NACE 2.

Deri më 31.12.2014 në QKB në Vushtrri janë kryer gjithsej këto shërbime:

<u>Nr.</u>	<u>Përshkrimi i aktivitetit</u>	<u>Nr.i llojit</u>	<u>Vërejtje</u>
1.	Biznese të reja (të regjistruara)	215	
2.	Shuarje të bizneseve	85	
3.	Ndërrime të logove të certifikatave	56	
4.	Ndryshime në bizneset ekzistuese	110	
	Gjithsej	466	

Në vazhdim do të japim pasqyrën tabelare të bizneseve të regjistruara gjatë periudhës 01.01 – 31.12.2014

Kodi	VEPRIMTARITË EKONOMIKE	Bizneset prej 01.01-31.12.2014	%
1	2	3	4
2	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria	31	14.42
3	Industria përpunuese	7	3.26
4	Ndërtimtaria	17	7.91
5	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe aparateve tjera të amvisërisë	69	32.09
6	Hotelet dhe restorantet	41	19.07
7	Transporti, depot dhe telekomunikacioni	22	10.23
8	Pasuritë e patundshme: dhënia me qira dhe aktivitetet e biznesit	8	3.72
9	Administrimi dhe mbrojtja publike, mbrojtja e obligueshme sociale	3	1.39
10	Arsimi	3	1.39
11	Aktivitet tjera shoqërore dhe personale	14	6.52
	Totali	215	100

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme nga 215 bizneset e regjistruara për periudhën 01. 01. deri më 31.12.2014 edhe më tutje dominon veprimtaria tregtare 32.09 % apo 69 biznese nga 215 biznese sa janë të regjistruara, pastaj bizneset hoteliere më 19.07 %, bujqësia më 14.42 %, ndërtimtaria më 7.91 %, etj.

Numri i të punësuarve në biznese:

Çdoherë mund të ndryshojë numri i punëtorëve si në kategorinë e të punësuarve po ashtu edhe në kategorinë e vetëpunësuar.

Në bazë të të dhënave të siguruar nga ATK – zyra regjionale në Mitrovicë, ekziston ky numër i të punësuarve:

-Punëtorë të paraqitur në biznese të vogla dhe të mesme.....	1868
- Punëtorë të paraqitur në biznese të mëdha (9 biznese).....	860
-Të vetëpunësuar në bizneset individuale.....	1520
-Të punësuar në biznese në njësitë jashtë Vushtrrisë.....	780
Gjithsej.....	4028

Ky numër i të punësuarve në biznese private është variabil dhe mund të ndryshojë qdoherë, bie fjala, gjatë sezonës së verës shumë biznese, të cilat merren me veprimtari ekonomike të prodhimit, përpunimit etj., mund të rrisin numrin e punëtorëve të tyre, për shkak të rritjes së volumit të punës, ndërsa gjatë sezonës së dimrit mund të bie.

Vlen për të theksuar se në këtë periudë raportuese vërehet një interesim i pronarëve të bizneseve për shuarjen e bizneseve pasive. Në këtë drejtim rol pozitiv po luan edhe Administrata Tatimore e Kosovës – zyra regjionale në Mitrovicë. Ky veprim ndikon drejtpërdrejt edhe në zvogëlimin e numrit të bizneseve jofunksionale, gjegjësisht pasive në komunën tonë.

Bizneset e shuara gjatë këtij viti janë biznese kryesisht të vogla individuale tregtare, por edhe ato bujqësore të cilat kanë marrë një certifikatë biznesi me qëllim të sigurimit të ndonjë donacioni, mirëpo në momentin që nuk e kanë fituar atë donacion e kanë shuar biznesin.

Në muajin nëntor 2014 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së bashku me Odën Ekonomike të Kosovës kanë zgjedhur bizneset më të suksesshme për regjionin e Mitrovicës ku dy kompanitë e Vushtrrisë janë zgjedhur si më të suksesshmet:

- **Kompania Pestova** ka marrë çmimin e parë në regjion, ndërsa
- **Kompania Berto** ka marrë çmimin e tretë.

Po ashtu gjatë vitit 2014 në raportin e Kosovës për Indeksin e Konkurrencës në Komuna, të organizuar nga Agjencioni UBO Consulting së bashku me përfaqësues të USAID – it, komuna jonë është shpërblyer me dy çmime:

- Vendin e parë si Komuna Top Reformatore
- Vendin e tretë për performancë për vitin 2014

Sektori për bujqësi

Në masën e subvencionimit të sipërfaqeve të mbjella me **grurë, misër, luledielli** kanë aplikuar gjithsej **683** fermerë;

Në masën e subvencionimit të sipërfaqeve të mbjella me **patate e perime tjera** kanë aplikuar gjithsej **198** fermerë;

Në masën e subvencionimit të deleve dhe dhive kanë aplikuar gjithsej **38** fermerë;

Në masën e subvencionimit të gjedheve qumështore kanë aplikuar gjithsej **333** fermerë;

Në masën e subvencionimit të shoqërive të bletëve kanë aplikuar gjithsej **62** fermerë;

Në masën e subvencionimit direkt të qumështit kanë aplikuar gjithsej **30** fermerë.

Janë subvencionuar si vijon:

- furnizim me serra në sipërfaqe prej gjysmëari 16 fermerë, si dhe nga një ari 5 fermerë, vlera: 32,400.00 €;
- furnizim me makina mjelëse për 285 fermerë në vlerë prej: 58,668.00 €;
- furnizim i 15 familjeve me nga 8 dhi qumështore në vlerë prej 66,033.00 € (projekt trevjeçar);
- furnizim me bletë për 30 fermerë në vlerë prej 10,919.40 €;
- furnizim me fidane të mjedrës për 30 fermerë në vlerë prej 35,800.00 €.

•Me IADK janë zhvilluar aktivitete të llojit të ndryshëm dhe atë kryesisht në perimekulturë dhe blegtori, ku fermerëve iu është mundësuar ndjekja e trajnimeve në degët kryesore të bujqësisë.

<u>Nr</u>	<u>Kultura</u>	<u>Mbjelljet 2013/14</u> <u>- rendimenti</u>	<u>Mbjelljet 2014/15</u> <u>- rendimenti</u>	<u>dallimi</u>
<u>1</u>	grurë	4200 - 4.7 t/ha	4100	
<u>2</u>	tërshërë	510 - 2.9 t/ha	225	

<u>3</u>	elb	210	- 3.4 t/ha		
<u>4</u>	misër	3700	-3.8 t/ha		
<u>5</u>	patate	1350	- 30t/ha		
<u>6</u>	Bimë foragjere	235			

Të dhënat për ujtjen dhe kullimin e tokave bujqësore

Fusha në:	Emri fshatit	Sipërfaqet nën ujtje		Sipërfaqet e përmbytura apo të rrezikuara nga përmbytjet		Tokat për kullim
		Burimi res. ujore	Sipërfaqet e ujitura/ha/	Emri lumit që shkakton përmbytjet	Sipërfaqet e përmbytura/ha/	Sipërfaqet që kanë nevojë për kullim/ha/
Fusha e Nadakocit	Nadakoc – Pestovë	Ibër-lepenc	1100	Silnica	220 ha	
Dobërlluka	Smrekonicë – Dobërllukë	Ibër - lepenc	780			
Mihaliq	Mihaliq	Ibër-lepenc	136			
	Druar					
Samadrexhë (është rehabilituar por ende nuk është lëshuar në funksion)	Sfaraçak	Ibër-lepenc	836			
	Studime e Ulët					
	Maxhunaj			Lumi Kuq	15	
	Stanoc i Epërm					
	Ropicë					
	Vilanc					
	Dumnicë e Ulët					
Pantinë (është jofunksionale)	Pantinë	Ibër-lepenc	918			
	Akrashticë					
	Balinc					
Banjskë (është	Banjskë Sllatinë	Ibër-lepenc	260			

jofunkionale)	Begaj, Vushtrri					
---------------	--------------------	--	--	--	--	--

Nr		SASIA	Gjithsej përmbajtja
1.	Kërkesa të paraqitura për leje-prerje	91	
2.	Kërkesa të kryera të shqyrtuara	62	1296.84 m3
3.	Damkosje dru zjarri nga APK ja, Mitrovica	61	1296.84 m3
4.	Pastrim në pyje publike	4.50 ha	Qyçavicë dhe Sllakoc
5.	Fletëpërcjellje të masës drunore	285	687.00m3 m3
6.	Fletëpagesa për pyje private	58	2107.50.50€
7.	Konfiskime	36	83.49 m3
8.	Shpërndarje e masës drunore	63	73.00m3
9.	Fl pagesa pyje shtetërore	5	285.00€
10.	Gjendja në depo	10.49 m3	
11	Pyllëzime	/	/
12.	Ripyllëzime	/	/

**Sekt
ori i
pyje
ve**

13.	Zjarre në pyje	2 raste	15 hektarë zjarre sipërfaqësore në pyje private
14.	Fletëparaqitje kundërvajtje	83	127.60m ³ =16098.61€
15.	Fletëparaqitje penale	92	290.09m ³ =35259.80€
16.	Gjithsej fletëparaqitje	175	417.69m ³ = 51358.41€

Prokurimi

I tërë aktiviteti i realizuar i prokurimit është bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë, nr. 04/L-042, Rregulloren e Prokurimit Publik, si dhe në Udhëzimet Administrative të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Në periudhën raportuese, janë iniciuar dhe realizuar 212 prokurime për t'i realizuar dhe përmbushur kërkesat për gjitha shtyllat e buxhetit të Autoritetit Kontraktues, si vijon:

- Administratë Komunale
- Arsim, duke përfshirë këtu gjitha shkollat e mesme dhe fillore, si dhe institucionin parashkollor.
- Shëndetësi dhe Qendër për Punë Sociale
- Njësia e zjarrfikësve
- Zyra lokale e komuniteteve, dhe
- Zyra për kthim të komuniteteve.

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat lidhur me planifikimin dhe realizimin e prokurimeve për vitin 2013.

II.1) KONTRATAT PËR FURNIZIM

Klasifikimi i Produktit (2 shifrat e para nga FPP)		Përshkrimi i kontratës	Njësia	Projekti është realizuar PO / JO
21	1	Furnizim me material zyrtar	Kon.	Po
15	2	Furnizim me artikuj ushqimor	Kon.	Po
11	3	Furnizimi me naftë dhe derivate të naftës	Kon.	Po
22	4	Furnizim me materiale të shtypura për zyra	Kon	Po
36	5	Furnizim me orendi për zyra	Kon.	Po
31	6	Furnizim me pajisje tjera	Kon.	Po
18	7	Furnizim me veshmbathje	Kon.	Po
24	8	Furnizim me material higjienik	Kon.	Po
30	9	Furnizim me teknologji informative dhe pajisje tjera elektronike	Kon.	Po
02	10	Furnizim me dru për ngrohje	M ³	Po
10	11	Furnizim me thëngjill për ngrohje	Ton	Po
30	12	Furnizim me aparate fotokopjuese	Kon.	Po
28	13	Furnizim me material teknik për mirëmbajtje të objekteve	Kon.	Po
33	14	Furnizim me material laboratorik, stomatologjik dhe medikamente për QKMF-të	Kon.	Po
34	15	Blerja e automjetit për bartjen e pacientëve për hemodializë	Kon.	Po
28	16	Furnizim me gypa për kanalizim dhe ujësjellës	Kon.	Po
22	17	Furnizim me inventar për objektet shëndetësore	Kon.	Po
29	18	Furnizim dhe instalim i kamerave në qytet	Kon.	Po
21	19	Furnizim me libra për bibliotekë	Kon.	Po
33	20	Furnizim me pajisje mjekësore dhe laboratorike	Kon.	Po
28	21	Furnizim dhe vendosje e shenjave horizontale dhe vertikale	Kon.	Po
22	22	Furnizim me inventar për objektin e shkollës fillore në fshatin Pestovë	Kon.	Po

II. 2) Kontratat për Shërbime

Klasifikimi i shërbimit (2 shifrat e para nga FPP)		Përshkrimi i kontratës	Projekti është realizuar PO / JO
50	1.	Servisimi i teknologjisë informative	po
78	2.	Botimet e reklamave dhe konkurseve	po
64	3.	Shërbimet e internetit	po
55	4.	Shërbime hoteliere	po
50	5.	Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	po
93	6.	Shërbime tjera kontraktuese të kohëpaskohëshme	po
74	7.	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës	po
64	8.	Shërbimet e telekomunikacionit	po
63	9.	Shërbimet e udhëtimit jashtë vendit	po
80	10	Shërbimet arsimore dhe trajnuese	po
85	11	Shërbimet e ndryshme shëndetësore	po
93	12	Regjistrimi dhe kontrolli teknik i automjeteve	Po
74	13	Hartimi i planeve rregulluese	po
74	14	Hartimi i projekteve	po
93	15	Pastrimi dhe larja e automjeteve	po
80	16	Shërbimet intelektuale dhe këshillëdhënëse	po
60	17	Shërbimet e udhëtimit brenda vendit	Po
50	18	Mirëmbajtja e mobilieve dhe pajisjeve	po

II. 3) KONTRATAT PËR PUNË

Klasifikimi i punëve (2 shifrat e para nga FPP)		Përshkrimi i kontratës / Karakteristikat thelbësore të secilës kontratë për punë	Projekti është realizuar PO / JO
45	1.	Asfaltim i rrugës „Dëshmorët e Kombit“ 2012 (asfaltim 2013-2014)	Në bazë të raporteve mbi ecurinë e punëve në projekt të dorëzuara nga organi mbikëqyrës dhe menaxheri i kontratës të komunës, rezulton se punimet në objekt kanë përfunduar në masën rreth 98 % të punëve të parapara sipas projektit, që do të

			thotë se kanë mbetur të përfundohen edhe disa punë që janë të ndërlidhura me rrjetin elektrik që duhen kryer në bashkëpunim me KEDS-in
45	2.	Asfaltim i rrugëve dhe urës në fshatin Pantinë, lagjja “Aliu”	po
45	3.	Asfaltim i rrugës lagjja e „Bajgorëve“ te gjimnazi	po
45	4.	Asfaltim i rrugës magjistrale - Sfaracak	po
45	5.	Asfaltim i rrugës në fshatin Kollë	po
45	6.	Punim dhe Montim i tabelave të rrugëve	po
45	7.	Asfaltim i rrugës në hyrje - dalje te komuna	po
45	8.	Punim dhe montim i numrave të shtëpive	Jo për shkak të pamundësisë së plotësimit të të hyrave vetjake. Projekti do të realizohet gjatë vitit 2015, pasi që tani, në vitin 2015, mjetet janë siguruar nga të hyrat vetjake të komunës të realizuara në muajin nëntor – dhjetor 2014.
45	9.	Asfaltim i rrugës në Gurbardh, lagjja “Gjaka – Sheremeti”	po
45	10	Asfaltim i rrugës Stanoc - Lumadh	po
45	11	Asfaltim i rrugës Karaçë - Gumnishtë	po
45	12	Asfaltim i rrugëve lokale në fshatin Samadrexhë	po
45	13	Asfaltim i rrugës në fshatin Beçuk, lagjja “Murati – Miftari”	po
45	14	Asfaltim i rrugës “Ismajl Qemajli-Wesly Clark-Bedri Pejani”	po
45	15	Asfaltim i rrugës Bukosh - Brusnik	po
45	16	Vendosja e shportave për hedhurina në qytet	po
45	17	Ndërtim dhe rregullim i ndriçimit publik	po
45	18	Riasfaltim i rrugëve dhe mirëmbajtje e rrugëve të asfaltuara	po
45	19	Ndërtim i urave	po
45	20	Mirëmbajtje e rrugëve të rendit të IV-të	po
45	21	Ndërtim i rrjetit të ujësjellësit	Jo për shkak të pamundësisë të plotësimit të të hyrave vetjake. Projekti do të realizohet gjatë vitit 2015, pasi që tani në vitin 2015 mjetet janë siguruar nga të hyrat vetjake të komunës të realizuara në muajin nëntor – dhjetor 2014.

45	22	Ndërtim i trotuareve dhe rrethojave nëpër varreza	Po
45	23	Rregullim i hapësirave të varrezave në fshatin Studime	po
45	24	Ndërtim i rrugëve me kubëza të betonit	po
45	25	Ndërtim i trotuareve	Po
45	26	Fondi për bashkëfinancim me donatorë	po
45	27	Ndërtim i kanalizimit fekal në fshatin Pantinë - projekt dyvjeçar	Duke qenë se projekti është dyvjeçar, punimet janë në ekzekutim e sipër edhe në vitin 2015
45	28	Ndërtim i kanalizimit fekal në tri Dumnicat - projekt trevjeçar	Duke qenë se projekti është trevjeçar, punimet janë në ekzekutim e sipër edhe në vitin 2015 dhe 2016.
45	29	Ndërtim i kanalizimit fekal në fshatrat Maxhunaj-Samadrexhë - projekt trevjeçar	Duke qenë se projekti është trevjeçar, punimet janë në ekzekutim e sipër edhe në vitin 2015 dhe 2016
45	30	Ndërtim i kanalizimit fekal në fshatin Studime - projekt dyvjeçar	Duke qenë se projekti është dyvjeçar, punimet janë në ekzekutim e sipër edhe në vitin 2015
45	31	Ndërtim i kanalizimit fekal në fshatin Begaj - projekt trevjeçar	Duke qenë se projekti është trevjeçar, punimet janë në ekzekutim e sipër edhe në vitin 2015 dhe 2016
45	32	Ndërtim i kanalizimit fekal në fshatin Bukosh - projekt dyvjeçar	Duke qenë se projekti është dyvjeçar, punimet janë në ekzekutim e sipër edhe në vitin 2015
45	33	Ndërtim i kanalizimit fekal në fshatrat Vërrnicë-Reznik - projekt dyvjeçar	Duke qenë se projekti është dyvjeçar, punimet janë në ekzekutim e sipër edhe në vitin 2015
45	34	Ndërtim i kanalizimit fekal në fshatin Mihaliq	po
45	35	Ndërtim i kanalizimit fekal në fshatin Druar - projekt dyvjeçar	Duke qenë se projekti është dyvjeçar, punimet janë në ekzekutim e sipër edhe në vitin 2015
45	36	Ndërtim i kanalizimit fekal në fshatrat Bivolak-Zhilivodë - projekt dyvjeçar	Duke qenë se projekti është dyvjeçar, punimet janë në ekzekutim e sipër edhe në vitin 2015
45	37	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatrat Vërrnicë-Kollë-Novolan - projekt trevjeçar	Duke qenë se projekti është trevjeçar, punimet janë në ekzekutim e sipër edhe në vitin 2015 dhe 2016
45	38	Rregullim i stacionit të autobusëve	Pasi që në objekt dhe pronë ka kontest gjyqësor, mjetet e planifikuara për këtë projekt, me

			vendim të Kuvendit Komunal, janë redistinuuar.
45	39	Ndërtim i depos me infrastrukturë përcjellëse	po
45	40	Rregullim i rethojës së oborrit të QMF-ve në fshatrat Novolan dhe Pantinë	po
45	41	Ndërtim i ambulancës dhe rregullim i oborrit të saj në fshatin Samadrexhë	po
45	42	Renovim i ambulancës në fshatin Stroc	Po
45	43	Ndërtim i ambulancës dhe rregullim i oborrit dhe rrethojës	po
45	44	Ndërtim i fushave sportive në Begaj dhe Artakoll	Po
45	45	Restaurim i trashëgimisë kulturore	Po
45	46	Blegtori	po
45	47	Bletari	po
45	48	Fondi me bashkëfinancim për bujqësi - ekonomi me donatorë	po
45	49	Rregullim i argjaturave të lumenjve	Po
45	50	Pemëtari	Po
45	51	Perimekulturë	Po
45	52	Ndërtim i shkollës fillore në Pestovë	Po
45	53	Renovim i shkollave	po
45	54	Gjelbërim i hapësirave publike	po

Vlen të theksohet se, përveç projekteve të planifikuara, e të cilat u pasqyruan në tabelë si më lart, ashtu sikurse kemi sqaruar dhe në tabelat e projekteve të planifikuara, me ridestinimin e mjeteve të mbetura nga projektet e realizuara me mjete financiare nga të hyrat vetjake dhe grantet qeveritare nga Ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, janë planifikuar dhe realizuar edhe një numër i konsiderueshëm i projekteve që nuk ishin të parapara në Planifikimin fillestar, e të cilat janë pasqyruar në mënyrë të detajuar, në Raportin përfundimtar të prokurimeve të proceduara nga Drejtoria për Prokurim në vitin kalendarik 2014, raport ky i bashkëngjitur në këtë raport pune.

Tab.nr.1 Projektet e realizuara nga mjetet e redistinuara në vitin fiskal 2014

Klasifikimi i punëve (2 shifrat e para nga FPP)	Nr. re.	Përshkrimi i kontratës / karakteristikat thelbësore të secilës kontratë për punë	Projekti është realizuar PO / JO
31	1	Furnizimi me makina mjelëse	Po
45	2	Ndërtim i murit mbrojtës në fsh. Miraçë	po
34	3	Furnizim me automjete terreni për	po

		nevoja të QKMF-ve	
33	4	Furnizim me pajisje mjekësore për QKMF-të	Po
45	5	Furnizim, demontim dhe montim i olluqeve në sh.f. “Mustafë Shyti“ në fsh. Ashlan	Po

Tab.nr.2 Projektet e realizuara nga mjetet – fondi për bashkëfinacim me donatorë

Klasifikimi i punëve (2 shifrat e para nga FPP)		Përshkrimi i kontratës / karakteristikat thelbësore të secilës kontratë për punë	Projekti është realizuar PO / JO
45	1	Punimi i trotuarit me kubëza betoni i rrugëve: "Bahri Kuçi"- magjistranja Prishtinë - Mitrovicë dhe "Faruk Beqiri"	po
45	2	Rregullimi i hapësirës gjelbëruese përbri lumit "Silnica" dhe shtegut në qytetin e Vushtrisë	Projekti financohet nga REC-i. Projekti është në realizim e sipër. Kushtet atmosferike dimërore kanë ndikuar që punimet të ndërpriten për të filluar në pranverë të këtij viti, 2015.

Nga gjithë aktivitetet e prokurimit të procesuara në këtë vit, 2014, me theks të veçantë te prokurimet për punë, në asnjë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur punë shtesë. Edhe ky fakt tregon sesi nga ana e drejtorisë ashtu dhe nga ana e Operatorëve ekonomik të përzgjedhur ka pasur një performancë të kënaqshme sa i takon realizimit, si në kohë ashtu dhe në cilësi, të ekzekutimit, gjegjësisht realizimit të projekteve.

Duhet theksuar po ashtu se për vonesa të paarsyeshme në përfundimin e projekteve sipas planit dinamik të kontraktuar, drejtoria ka qenë e detyruar që konform dispozitave të LPP-së dhe kushteve të përcaktuara në Kontratën e punës, të aplikojë penale ndaj disa Operatorëve ekonomik (5 Operatorëve ekonomik). Vonesat nuk kanë qenë të asaj natyre sa të rrezikojnë realizimin e projekteve, në rend të parë në aspektin cilësor dhe sasior. Vlera financiare e aplikimit të penaleve kap shumën prej 2,462.85€.

Tabela e dhënë në vijim, Nr. 4 dhe 5 pasqyron në mënyrë më të detajuar llojin e procedurës së shfrytëzuar, pjesëmarrjen e llojit të procedurës në numrin e përgjithshëm të prokurimeve, si dhe pjesëmarrjen në përqindje të procedurave në aktivitetet e përgjithshme të prokurimeve të realizuara gjatë vitit 2013 dhe 2014.

Tab. Nr. 4.

Viti 2013 Prokurimet e realizuara përmes zbatimit të procedurave të prokurimit (neni 33-37 të LPP-së) – LPP nr.04/L-042					
Mjetet financiare	Procedurë e hapur	Proc. e neg. pa publ. e njoft. të kontratës	Procedurë e kuotimit të çmimeve	Procedurë për kontratat në vlerë minimale	Gjithsej
Të zotuar	4.845.551,47€	00	183.722,22€	63.286,10€	5.092.559,79€
Të kontraktuara	4.230.419,36€	00	178.140,49€	61.437,76€	4.469.997,6€
Diferenca	615.132,11€	00	5.581,73€	1.848,34€	622.561,18€
Pjesëmarrja në %, sipas proced.	94.64%		3.99%	1.37%	100%

Tab. Nr. 5.

Viti 2014 Prokurimet e realizuara përmes zbatimit të procedurave të prokurimit (neni 33-37 të LPP-së) – LPP nr.04/L-042					
Mjetet financiare	Procedurë e hapur (€)	Proc. e neg. pa publ. e njoft. të kontratës	Procedurë e kuotimit të çmimeve (€)	Procedurë për kontrata në vlerë minimale	Gjithsej (€)
Të zotuara	3.486.984,68	00	211.544.08	54.540,17	3.753.068,93
Të kontraktuara	2.789.940,46	00	208.350,91	52.944,71	3.051.236,08
Diferenca	697.044,22	00	3.193,17	1.595.46	701.832,85
Pjesëmarrja në %, sipas procedurës	92.91%	--	5.64%	1.45%	100%

Nga analiza e të dhënave të paraqitura si në tabelën nr. 5 mund të nxjerrim konkludimin se edhe në këtë vit kursimet më të mëdha janë realizuar në rastin e zbatimit të procedurës së hapur, me vetë faktin se aty janë koncentruar edhe mjetet financiare më të mëdha, ndërsa në raport me shumën e përgjithshme të investimeve, gjegjësisht vlerës së prokurimeve në vitin 2013 ku kemi pasur një mbetje nga aktiviteti i prokurimeve kursim rreth 12.22% nga vlera e buxhetit të përgjithshëm të orientuar në investime për punë, mallra dhe shërbime. Në vitin 2014 kemi një mbetje – kursim prej rreth 18,70 % nga vlera e buxhetit të përgjithshëm të orientuar në investime për punë, mallra dhe shërbime, apo shprehur në vlerë financiare, në shumë prej 701.832,85€.

Konsiderojmë me interes të theksojmë se nga gjitha prokurimet e realizuara në këtë vit, që po i referohet edhe ky Raport pune, nuk kemi të evidentuar asnjë ankesë në OSHP (Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik).

Tab. Nr. 6. Pasqyra tabelare sipas lëndës së prokurimeve në vitin 2013

	Mjete financiare të zotuara	Mjete financiare të kontraktuara	Pjesëmarrja në % në vlerën e përgjithshme
Furnizime	1.063.757,89€	932.209,52€	20.86 %
Shërbime	630.479,87€	537.938,85€	12.03 %
Shërbime konsulente	/	/	/
Punë	3.398.322,03€	2.999.849,24€	67.11 %
Pronësi e paluajtshme	/	/	/
Gjithsej	5.092.559,79€	4.469.997,61€	100 %

Tab. Nr. 7. Pasqyra tabelare sipas lëndës së prokurimeve në vitin 2014

	Mjete financiare të zotuara	Mjete financiare të kontraktuara	Pjesëmarrja në % në vlerën e përgjithshme
Furnizime	837.664,39€	750.285,84€	24.59%
Shërbime	754.858,26€	720.776,50€	23.62%
Shërbime konsulente	/	/	/
Punë	2.160.546,28€	1.580.173,74€	51.79%
Pronësi e paluajtshme	/	/	/
Gjithsej	3.753.068.93€	3.051.236,08€	100 %

Shërbimet publike

Drejtoria për Shërbime Publike bën rregullimin e qytetit dhe mbrojtjen e ambientit; mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale të asfaltuara dhe të rendit të katërt; rregullimin e qarkullimit të komunikacionit; sinjalizimin horizontal dhe vertikal; parkingjet; transportin lokal; përcjell largimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet publike; mbikëqyr punën e lëmisë së furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të zeza; menaxhon procedurat e bartjes dhe deponimit të hedhurinave; pastrimin dhe larjen e rrugëve; shesheve dhe sipërfaqeve publike; mirëmbajtjen e shtratit të lumenjve; mirëmbajtjen e ndriçimit publik; mirëmbajtjen e varrezave, parqeve dhe gjelbërimit të qytetit; mbikëqyr dhe menaxhon punën e autoparkut të Kuvendit Komunal, etj.

Në Sektorin për komunikacion, janë shqyrtuar dhe proceduar shumë lëndë, për të cilat janë nxjerrë vendimet e nevojshme nga ky sektor, është bërë planifikimi i vijave, përgatitja dhe shpallja e konkursit, si dhe dhënia e lejeve të punës së bashku me rendin e udhëtimit kompanive transportuese për bartjen e rregullt publike të udhëtarëve. E gjithë kjo është bërë në bashkëpunim të ngushtë me kompanitë transportuese.

Është hartuar rregullorja e re për organizimin e transportit të rregullt të udhëtarëve brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë, e cila është miratuar në parim dhe është dhënë në diskutim publik. Një numër kërkesash i janë adresuar Ministrisë së Infrastrukturës për mirëmbajtjen verore të rrugëve regjionale, në territorin e Komunës së Vushtrrisë. Në këtë kuadër është realizuar projekti për riasfaltimin e pjesës së mbetur të rrugës regjionale M2-Samadrexhë riasfaltimin e një pjese të rrugës regjionale Vushtri – Novolan - Obiliq, si dhe ndërtimi i trotuarit Vushtri – Bukosh. Po ashtu Ministria e Infrastrukturës ka aprovuar kërkesat tona për rregullimin e udhëkryqeve në segmentin e rrugës magjistrale M2 që kalon brenda qytetit të Vushtrrisë.

Shërbimi i autoparkut, posedon 19 automjete, prej të cilave 14 janë në funksion. Shpenzimet dhe kilometrat e kaluara për periudhën janar-dhjetor 2014 janë si në tabelën në vijim.

Muaji	Km të kaluara	Litra	Mesatarja
Janar	11635	1228	10,58
Shkurt	15796	1723	10,90
Mars	15635	1657	10,59
Prill	18482	1970	10,65
Maj	19325	1926	9,96
Qershor	19223	2063	10.73

Korrik	17973	2067	11,50
Gusht	13673	1499	10,96
Shtator	20701	2240	10,82
Tetor	20498	2212	10,79
Nëntor	21811	2420	11,09
Dhjetor	19730	2190	11,09
Total	214482 [km]	23195 [l]	10.81[l/100km]

Sektori për shërbime publike

Furnizimi me ujë. Çështja e ujit të pijshëm mbetet problem i pazgjidhur për qytetarët e komunës sonë deri në përfundimin e ndërtimit të fabrikës së re për përpunimin e ujit në Sukë të Oshlanit. Gjatë këtij viti, fabrika pothuajse ka përfunduar së ndërtuari. Pritet që shumë shpejt të përmirësohet furnizimi me ujë të pijshëm për qytetarët, përndryshe vitin që lam pas furnizimi me ujë të pijshëm është përmirësuar dukshëm.

Largimi i ujërave të zeza.- gjatë periudhës raportuese filloi realizimi i disa projekteve të ndërtimit të kanalizimit, si në qytet ashtu edhe në shumë fshatra të komunës. DSHP-ja i ka përkrahur banorët e lagjeve në qytet dhe fshatra ku nuk ka rrjet të kanalizimit me dhënien e gypave për kanalizim, ndërsa puna për vendosjen e tyre është bërë nga komuniteti.

Mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit e bënë kompania e licencuar Ujësjiellësi regional “Mitrovica” - njësia në Vushtri, për çka konsumatorët paguajnë 0.05 €/m³ për ujin e harxhuar, mirëpo pagesa për ujë është e dobët andaj edhe pjesa për mirëmbajtjen e kolektorëve të kanalizimit është simbolike.

Largimi i ujërave atmosferike. Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhësve të prrockave dhe rrjedhave të ujit në qytet.

Hedhurinat - ndërmarrja për menaxhimin e hedhurinave, vepron si kompani regjionale “Uniteti” Sh.A. në Mitrovicë, njësia operative në Vushtri. Kjo kompani është e vetmja e licencuar nga Zyra Rregullative për ushtrimin e kësaj veprimtarie në regjionin e Mitrovicës. Njësia operative është relativisht mirë e pajisur me kontejner dhe teknikën për transferim të hedhurinave deri në deponinë qendrore në Gërmovë të Mitrovicës, mirëpo kësaj kompanie i mungojnë pajisjet speciale për larjen dhe pastrimin e rrugëve. Mund të thuhet se edhe gjatë kësaj periudhe ndërmarrja me sukses e ka bërë grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave, ndërsa si veprimtari dytësore ka kryer punë të kontraktuara si: pastrimin e rrugëve të qytetit, punë të ndryshme komunale, pastrimin e rrugëve nga bora e akulli, etj. Po ashtu me këtë kompani është lidhur kontrata për larjen e rrugëve, realizimi i së cilës po bëhet me sukses.

Ndriçimi publik, po vazhdon me sukses zbatimi i kontratës për mirëmbajtje të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra. Është zgjeruar rrjeti i ndriçimit publik me bashkëfinancim me komunitetin në 2 fshatra dhe 7 rrugë në qytet me gjithsej 131 trupa ndriçues dhe gjatësi të rrjetit prej 4585 m.

Mirëmbajtja e varrezave - gjatë kësaj periudhe iu kushtua kujdes i merituar. U bë kositja dhe largimi i barit, u punua në mirëmbajtjen e rrethojës dhe punë tjera në varrezat e dëshmorëve, martirëve dhe ato të qytetit etj.

Urbanizmi

Sektori për Urbanizëm i ka kryer këto punë:

Kërkesa për leje - pëlqime urbanistike: kushte ndërtimore -59, pëlqime urbanistike -11, refuzime -18, si dhe kërkesa tjera të qytetarëve: pranime teknike – 27, vlerësim i tenderëve – 31, punë të ndryshme -10, takime të ndryshme – 9, Gjithsej- 77.

Sektori për planifikim hapësinor, kërkesa të qytetarëve - 63, vlerësime dhe hapje të ofertave-38, pranime teknike të objekteve - 25, mbikëqyrje të objekteve – 14, vlerësim për shtëpitë e djegura -1, paramasa dhe paralogari të ndryshme – 6, komisione të ndryshme -14.

Janë kryer detyra projektuese për hartimin e projekteve të ndryshme dhe skica për disa projekte më specifike, si dhe: kushte ndërtimore -59, leje ndërtimore -52, refuzim i lejeve urbanistike -15, refuzim i lejeve ndërtimore -15.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/ L-174 me të cilin jemi të obliguar të bëjmë ndryshimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-ës) ne si drejtori kemi filluar menjëherë procedurat bazuar në dispozitat ligjore, kemi përgatitur propozim-vendimin për ndryshimin e Planit Zhvillimor Komunal në muajin prill, kemi iniciuar procedurat për shpalljen e tenderit për kompaninë për Hartimin e PZHK-ës ku edhe është përzgjedh kompania e cila ka fituar projektin për Hartimin e PZHK-ës. Jemi në fazën e përfundimit të profilin të komunës ku kemi mbajtur shumë takime me kompaninë e cila është përfutuese e hartimit të këtij projekti. Gjithashtu kemi fituar projektin nga USAID-i që debatim publik me qytetar ta mbajnë CHwB-ja e cila duhet të mbajë takim me qytetarët pas çdo faze të hartimit duke përfshirë tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Urbanisti, mbikëqyrje të punimeve në 8 projekte, Komisione për pranime teknike 10 raste, Komisione për vlerësim të ofertave 15 raste, lëshime të pëlqimeve 1 rast, leje paraprake 2 raste_lëshime të vërtetimeve 2 raste, lëshime të informatave 3 raste.

Unifikimi i adresave, është bërë vendosja e shtyllave dhe tabelave me emra të rrugëve në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë nga kompania punëkryese “Malësia” nga Burimi, kurse punët kanë filluar më 25.08.2014 dhe janë në përfundim e sipër.

Faza e parë e procesit të legalizimit (nëntor 2014 – shkurt 2015). Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.04/L-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, më datën 12 nëntor 2014 ia kemi filluar hapave të parë lidhur me strategjitë dhe mënyrën sa më efektive të shpërndarjes së njoftimit dhe rëndësisë së procesit të legalizimit tek qytetarët.

Më 13 dhe 14 nëntor 2014 bëhet përgatitja e njoftimit dhe printohet një numër i madh i fletëaplikacioneve në mënyrë që secili qytetar të ketë sa më të lehtë të pajiset me fletëaplikacion. Këto njoftime dhe fletëaplikacione janë shpërndarë gjithandej qytetit dhe fshatrave. Më 25 nëntor 2014 arrijnë kërkesat e para për legalizim. Edhe pse në numër të vogël fillimisht, megjithatë po tregohet një interesim nga qytetarët për legalizimin e ndërtimeve pa leje. Në ditët në vijim numri i kërkesave për legalizim vetëm sa po shtohet.

Administrata

Sektori i gjendjes civile – punët dhe aktivitetet:

Më datë 26.02.2014 në ambientin e ARC/MPB-së në Prishtinë është bërë nënshkrimi i pranim-dorëzimit të 919 kopjeve të certifikuara të librave origjinale civile dhe fetare.

Ngritja e efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve më të mira dhe më efikase është në rritje duke iu falënderuar angazhimit dhe punës që bëjnë zyrtarët e gjendjes civile dhe po ashtu në këtë trend pozitiv ka ndikuar edhe kthimi i librave të gjendjes civile dhe atyre fetare, ngase, kanë ndikuar në lehtësimin dhe shpejtimin e procedurave për t’u pajisur me certifikata dhe dokumente të gjendjes civile.

Me aplikimin e programit të ri të gjendjes civile janë hequr librat fizikë dhe në rastin e regjistrimit shtypet një akt i cili pasqyron shënimet e gjendjes civile për atë regjistrim.

Të gjitha këto akte të lindjes, martesave dhe të vdekjeve i kemi dorëzuar në ARC/DRGJC/MBP në Prishtinë për t'u bërë lidhja e tyre dhe krijimi i librave fizikë ashtu siç e parasheh Ligji për gjendjen civile. Totali i këtyre akteve është 903 akte të lindjeve, 665 akte të martesave dhe 257 akte të vdekjeve.

Numri i dokumenteve të lëshuara

Nr.	Përshkrimi	Të lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	38639
2.	Certifikata të lindjes	6623
3.	Certifikata të martesës	5118
4.	Certifikata të vdekjes	1401
5.	Certifikata të statusit martesor	2014
6.	Certifikata të shtetësisë	1098
7.	Certifikata familjare	5272
8.	Certifikata të vendbanimit	1256
9.	Vërtetim nga arkivi	3320
10.	Akt i vdekjes	420
11.	Deklarata e Atësisë dhe Amësisë	1321
12.	Lajmërim dhe çlajmërim i vendbanimit	3562
Gjithsej		70044

Prej 70044 certifikata dhe dokumenteve të lëshuara, 15200 dokumente janë lëshuar pa pagesë për raste të ndryshme (raste sociale, veteranë, familje të dëshmorëve, invalidë etj., e kategori të ndryshme të parapara me Rregulloren për Tarifa të Komunës së Vushtrrisë).

Regjistrime në Regjistrat e gjendjes civile

1	Regjistrime të lindjes	587
2	Martesa	606
3	Regjistrime të vdekjes	350
4	Regjistrime të shtetësisë	60
5	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	498
6	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	128
7	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	37
Gjithsej regjistrime të bëra		2266

Në këtë periudhë janë verifikuar 24782 qytetarë në sistemin e ri të gjendjes civile, ndërsa që nga fillimi i sistemit të ri më 19.02.2013 janë të verifikuar apo të regjistruar në sistem 57423 qytetarë.

Qendra për shërbim të qytetarëve (QSHQ):

Kjo qendër aktivitetin e vet e bazon kryesisht në pranimin e kërkesave nga qytetarët dhe shpërndarjen e atyre kërkesave nëpër drejtori – zyrat përkatëse, si dhe pranimin e përgjigjeve (vendimeve) nga këto drejtori – zyra, me qëllim të shpërndarjes së tyre deri tek qytetari, i cili ka parashtruar kërkesë.

Numri i lëndëve dhe statusit të zgjidhjes për këtë periudhë

Në proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur poshtë	Pezulluar	Totali i lëndëve
1565	62275	1546	308	28	65722

Sektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative

Shërbimi i lekturimit gjatë kësaj periudhe kohore ka lekturuar 143 dokumente të ndryshe për të gjitha organet dhe shërbimet e administratës komunale si: procesverbale, vendime, rregullore, urdhëresa, raporte, informata e dokumente tjera.

Shërbimi i përkthimit gjatë kësaj periudhe ka përkthyer 198 dokumente të ndryshme, për nevojat e administratës komunale si procesverbale, kërkesa, njoftime, vendime, ankesa etj., si dhe ka asistuar me përkthim simulant nëpër takime të ndryshme në 100 raste.

Shërbimi për teknologji informative i ka asistuar vazhdimisht Zyrës së informacionit lidhur me mirëmbajtjen e faqes zyrtare të komunës në internet, si dhe avancimin e saj. Gjithashtu me vënien në funksion të aplikacioneve të reja si: intraneti, e-Pasuria, e-Arkiva dhe ueb faqja e re, shërbimi për TI iu kemi ofruar mbështetje stafit lidhur me përdorimin e këtyre aplikacioneve. Kemi ndërmarrë veprime lidhur me hapjen e emaila-ve zyrtarë sipas kërkesave të nëpunësve komunal.

Përshkrimi i punëve dhe detyrave të kryera nga Shërbimi për teknologji informative	
Formatizime dhe instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshëm.	153
Mbështetje për personel në shfrytëzimin e resurseve të teknologjisë informative.	265
Zgjidhje e problemeve dhe defekteve të ndryshme.	196
Backup i (ruajtja e të dhënave) aplikacioneve.	262
Mirëmbajtja e ueb-faqes.	93

Zyra e të drejtave të njeriut

Gjatë kësaj periudhe punën e NJKDNJ e kanë karakterizuar disa aktivitete mes tjerash do t'i veçonim: Pjesëmarrja e rregullt e ZBGJ-së në mbledhjen e KKSB-së; në Komision për kthim dhe riatdhësim në mbledhjet e Kuvendit Komunal; pjesëmarrja në trajnimin e KKSB-së me temë dialogu ndëretnik, organizuar nga Ambasada Norvegjeze, kurse takimi u mbajt në Durrës; pjesëmarrja në conference, organizuar nga KiE dhe certifikimi i zyrtarit komunal për të drejta të njeriut;

- ZDK ka pasur 52 vizita dhe takime me komunitete, si komunitetit rom, ashkali, vizita komunitetit serb në fshatrat serbe, ndërkaq qëllimi i vizitave ka qenë integrimi i komuniteteve në shoqëri, si dhe ka shqyrtuar ankesën e komunitetit rom;

- Vizita e NJKDNJ në 22 shkolla fillore ku u diskutua për sigurinë, të drejtat e fëmijëve, obligimet e tyre dhe fushata vetëdijesuese “Jo drogës”;

- Pjesëmarrja e ZBGJ-së në tryezën regjionale me temë “Roli i grave në qeverisjen lokale” me përfaqësuesin e OSBE-së;

- Mbështetje grave kryefamiljare për zhvillimin e biznesit në përgatitjen e ushqimit tradicional ku janë punësuar 6 gra;
- Organizimi i tryezës kundër kancerit të gjirit;
- Takimet e ZBGJ-së me GGA ku i ka organizuar OSBE, lidhur me buxhetimin gjinor;
- Pjesëmarrja e ZBGJ-së në trajnim, organizuar nga OSBE, lidhur me trashëgiminë e grave në Kosovë;
- Pjesëmarrja e Grupit të Grave dhe ZBGJ-së në Strugë ku u diskutua për avancimin e grave në pozita vendimmarrëse në pushtetin lokal.

Arsimi

Duke pasqyruar punën e Drejtorise se Arsimit, drejtorëve, mësimdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor gjatë vitit 2014, vit i cili ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara, si në:

- Përmirësimin e punës pedagogjike-profesionale,
- Trajnimin e mësimdhënësve dhe drejtorëve,
- Pranimin e personelit të mësimdhënësve në konkursin e rregullt,
- Shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve,
- Planifikimin, menaxhimin dhe monitorimin e buxhetit, si dhe
- Sistemimin e kuadrit të tepërt si pasojë e shuarjes së klasave të XIII-ta

Përfundimi i vitit shkollor 2013 – 14

Niveli 0 (parashkollor dhe parafillor)

Arsimimi dhe edukimi parashkollor në komunën tonë gjatë vitit shkollor 2013 - 14 u zhvillua në institucionin parashkollor “Foleja” dhe klasave parafillore publike, të cilat ndodhen në shkollat: SHF “Ali Kelmendi” (119 nxënës), SHFMU “A.Z.Çajupi” (90 nxënës), SHFMU “Lumni Surdulli” (20 nxënës), SHF “Mustafë Venhari” (63 nxënës) dhe SHFMU “Lumadhi” (30 nxënës) dhe 177 nxënës parafillor janë të përfshirë privat (me participim të prindërve) në disa shkolla. Kështu, në nivelin 0 në institucione publike u përfshinë 461 fëmijë, ndërsa në institucionet publiko-private 177 fëmijë (gjithsej 638 fëmijë në nivelin 0).

Gjatë vitit shkollor 2013-14 janë regjistruar 158 fëmijë të grup-moshave të ndryshme në 8 paralele. Punën profesionale edukative arsimore dhe kujdesin shëndetësor – higjienik më fëmijë në këtë institucion e organizuan edukatorët (personeli edukativ) dhe motrat medicinale (stafi medicinal), ndërsa mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e gjithmbarshme e bën drejtoria e çerdhes me personelin profesional dhe administrativ. Komuna, nëpërmjet DA-së vazhdimisht e përcjell dhe e ndihmon punën e kësaj qendre. Duke pasur parasysh rëndësinë e edukimit dhe arsimimit parashkollor, si dhe interesimin e madh të prindërve për regjistrimin e fëmijëve në këtë nivel, DA në Vushtrri ka lejuar hapjen dhe funksionimin e paraleleve parafillore në kuadër të shkollave, ku ka kushte për punë me këta fëmijë, me participim të prindërve.

Niveli 1 (klasa I - V) Gjatë vitit shkollor kanë qenë 299 paralele me 6034 nxënës të regjistruar. Me sukses pozitiv kanë qenë 6012 nxënës ose 99.45%, ndërsa me sukses negativ kanë qenë 8 nxënës ose 0.14 %.

Niveli 2 (klasa VI - IX) Niveli -2 , në të cilën përfshihen nxënësit nga klasa e gjashtë e deri në klasën e nëntë, në fund të vitit shkollor 2013/2014 kanë qenë 229 paralele me 5618 nxënës. Në këtë nivel me sukses pozitiv kanë qenë 5585 nxënës ose 99.41%, me sukses negativ 11 nxënës ose 0.19% , dhe të panotuar kanë qenë 22 nxënës ose 0,39%.

Nga drejtoritë e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta dhe në veçanti nga mësimdhënësit e klasave të nënta, është punuar në realizimin e planprogramit mësimor, i cili është një planprogram orientues për përgatitjen e nxënësve për klasën e dhjetë të shkollës së mesme të lartë.

Niveli 3 (kl.X-XIII) Niveli -3 përfshin nga klasa e dhjetë (10) deri në klasën e trembëdhjetë (13). Në fund të vitit shkollor 2013-14 në tri shkollat e mesme të larta kanë qenë 138 paralele me 4159 nxënës. Nga këta nxënës, me sukses pozitiv kanë qenë 4117 ose 88.99%, kurse me sukses negativ 8 nxënës ose 0.19% dhe të panotuar 34 nxënës ose 0.81%. Ky numër i të panotuarve është për arsye se mësimi i lartë nuk është i obliguar.

Nxënës me nevoja të veçanta kanë qenë 11. Këta nxënës ishin të ndarë në dy klasa, të cilat funksiononin në shkollën fillore “Ali Kelmendi” dhe me të cilët punojnë dy mësimdhënëse me kualifikim pedagogjik special (pedagoge). Qëllimi i punës profesionale me këta fëmijë është që nëpërmes programeve të përshtatura mësimore të bëhet i mundur integrimi dhe aftësimi gradual i tyre për kyçje në jetën normale. Këto dy paralele në këtë vit shkollor janë përfshirë në kuadër të DA-së. Më parë, paralelet në fjalë kanë qenë të përfshira në kuadër të MASHT-it. Nga MASHT-i është ndarë buxhet shtesë për këto paralele të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Përfundim: Gjatë vitit shkollor 2013 – 14 kanë qenë 15811 nxënës, nga të cilët 15733 janë me sukses pozitiv apo 99.50%, 14 nxënës përsëritës apo 0.08% dhe 64 braktisës apo 0.40%.

Aktivitetet e lira

Në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta të komunës sonë, krahas realizimit të planprogrameve mësimore, është punuar edhe në veprimtaritë e lira arsimore dhe edukative, të cilat kanë ndikuar pozitivisht për një sukses sa më cilësor të nxënësve. Nxënësit e komunës sonë kanë marrë pjesë vazhdimisht në garat, të cilat janë organizuar për lëndët e ndryshme, si: matematikë, gjuhë shqipe, art, edukatë fizike etj.

Garat sportive - Garat komunale

FUTBOLL:

Vendi i parë: Shkolla e Mesme Profesionale “Bahri Haxha“ Vushtrri
Vendi i parë: Shkolla e Mesme e Ulët “1” Vushtrri

VOLEJBOLL:

Vendi i parë F.: Shkolla e Mesme e Ulët “Rexhep Musa“ Ceceli
Vendi i parë M.: Shkolla e Mesme e Ulët “Bahri Kuqi” Shtruhërë
Vendi i parë F.: Shkolla e Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” Vushtrri
Vendi i parë M.: Shkolla e Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” Vushtrri

BASKETBOLL:

Vendi i parë F.: SHMU “2“ Vushtrri
Vendi i parë M.: SHMU “2“ Vushtrri
Vendi i parë M.: Shkolla e Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” Vushtrri

HENDBOLL:

Vendi i parë F.: SHFMU “Andon Z. Çajupi” Vushtrri
Vendi i parë M.: SHMU “2” Vushtrri

Vendi i parë F.: Shkolla e Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” Vushtrri
Vendi i parë M.: Shkolla e Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” Vushtrri

PING PONG:

Vendi i parë: SHMU “2” Vushtrri

ATLETIKË

Vendi i parë: SHFMU “Andon Z. Çajupi” Vushtrri

Vendi i parë: SHMT “Lutfi Musiqi” Vushtrri

SHMT “Lutfi Musiqi” Vushtrri, organizoi garën me biçikleta në nivel komune për nxënësit e klasave të VI, VII, VII.X. XI. XII, kurse vendin e parë e zuri nxënësi nga SHMU “2” Vushtrri

Garat regjionale

FUTBOLL:

Vendi i parë: Shkolla e Mesme Profesionale “Bahri Haxha” Vushtrri

VOLEJBOLL:

Vendi i parë M.: Shkolla e Mesme e Ulët “Bahri Kuqi” Shtrruherë

Vendi i parë M.: Shkolla e Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” Vushtrri

BASKETBOLL:

Vendi i parë M.:SHMU “2” Vushtrri

Vendi i parë M.: Shkolla e Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” Vushtrri

HENDBOLL:

Vendi i parë F.: SHFMU “Andon Z. Çajupi” Vushtrri

Vendi i parë M.: SHFMU “2” Vushtrri

Vendi i parë F.: Shkolla e Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” Vushtrri

Vendi i parë M.: Shkolla e Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” Vushtrri

PING PONG:

Vendi i parë: Shkolla e Mesme e Ulët “2” Vushtrri

Garat republikane:

Në garat sportive në nivel shtetëror, nxënësit e Komunës së Vushtrrisë sollën këto vende:

VENDET E PARA

PING PONG: SHMU “2”

HENDBOLL: SHMU “2” Meshkujt

BASKETBOLL: SHMU “2” Meshkujt

VOLEJBOLL: SHFMU "Bahri Kuqi" Meshkujt

VENDET E DYTA

BASKETBOLL: SHMU “2” Femrat

FUTSALL: SHMP "Bahri Haxha" Meshkujt

HENDBOLL: SHMT "Lutfi Musiqi" Meshkujt

VOLEJBOLL: SHMT "Lutfi Musiqi" Meshkujt

Gjatë muajit mars 2014 është mbajtur Olimpiada e Matematikës, në të cilën, shkollat e Vushtrrisë arritën suksese të konsiderueshme. Kështu, në nivel regjional, vendin e parë e zuri SHMU “2”, ndërsa në nivel republikan, vendin e pestë e zuri gjimnazi “Eqrem Çabej” dhe vendin e tetë SHFMU “A. Z. Çajupi”.

TESTI I ARRITSHMËRISË DHE TESTI I MATURËS

Testi i arritshmërisë

Testi i arritshmërisë me nxënësit e klasave të nënta është mbajtur më 28 maj 2014. Testit iu janë nënshtruar 1233 nxënës. Nga këta nxënës, të rregullt kanë qenë 1227 dhe 6 kanë qenë me mësim joformal. Rezultati i testit të arritshmërisë ka qenë me një mesatare 76 poena për një nxënës, sepse në këtë test nuk ka prag të kalueshmërisë, d.m.th. të gjithë nxënësit kalojnë. E kthyer në notë mesatare, i bie se ka qenë shumë mirë apo 3,6, nota është 4.

Testi i maturës

Testi i maturës është mbajtur në dy afate (14 e 28 qershor dhe 29 gusht e 06 shtator). Testit të maturës iu janë nënshtruar 1962 maturantë. Në raport me vitet e tjera, numri i nxënësve që kanë hyrë në test të maturës ka qenë dukshëm më i madh, për arsye se në këtë vit shkollor, në dy shkollat profesionale, maturantë kanë qenë edhe klasat e dymbëdhjeta. Në bazë të rezultateve, shihet se kalueshmëria më e madhe ka qenë në gjimnazin “Eqrem Çabej” (99%), pastaj është SHMP “Bahri Haxha” (70%) dhe SHMT “Lutfi Musiqi” (49%)

Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2014/2015

Përgatitjet higjieno-teknike dhe për kuadrin arsimor për fillim-vitin shkollor 2014 – 15 përfunduan me kohë. Viti shkollor 2014/15 filloi më 01.09.2014. Sikurse viteve të tjera, edhe në këtë vit shkollor u shpërndan librat falas nga MASHT-i, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës për klasat I - IX. DA-ja shpërndau librat me kohë nëpër secilën shkollë të komunës sonë. Gjithashtu edhe drejtoritë e shkollave kanë shpërndarë librat të nxënësit që në javën e parë të fillimit të vitit shkollor, pra të gjithë nxënësit e komunës sonë janë pajisur me tekste shkollore. Dy shkollat fillore në qytet: SHF “Mustafë Venhari” dhe SHF “Ali Kelmendi” filluan vitin e ri në objektet e renovuara dhe në kushte shumë më të mira se në vitet e kaluara. Vështirësi në fillimin e këtij viti shkollor ishte mungesa e transportimit të nxënësve, si pasojë e mungesës së mjeteve financiare.

DA-ja në bashkëpunim me OJQ “Qendra për Demokratizim të Shoqërisë Civile” - Mitrovicë, ka përfituar një donacion nga UNICEF-i për mbështetjen financiare të disa mësimdhënësve me fëmijë parashkollor. Kjo organizatë është mbështetëse e komunës sonë që nga viti 2012, derisa në këtë vit shkollor përkras këto shkolla: SHF “Ali Kelmendi”, SHFMU – Lumadhi, SHFMU “Lumni Surdulli” – Samadrexhë.

Bazuar në Planin Strategjik për Arsim në Kosovë (PSAK), Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale „Bahri Haxha” Vushtrri dhe Shkolla e Mesme e Lartë Teknike „Lutfi Musiqi” për zhvillimin e sistemit të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP), ofrojnë dy lloje të programeve të nxënies të bazuar në punë - nxënia e bazuar në punë në punishtet e tyre, dhe praktikë profesionale nëpër ndërmarrje, ku mësimin teorik janë duke e ndërlidhur me mësimin praktik.

SHMLP „Bahri Haxha” në Vushtrri - Ka bashkëpunim me 14 ndërmarrje ku nxënësit njoftohen me teknologji, kurse 21 nxënës e zhvillojnë praktikën profesionale në 7 (shtatë) ndërmarrje.

Në marrëveshje me Shkollën e Tekstilit „BUTKEN” nga Bursa e Turqisë, janë dërguar 10 vajza në këtë shkollë për realizimin e praktikës nga data: 10 maj 2014 e deri më datën: 10 qershor 2014 dhe tani janë duke zhvilluar veprimtari praktike në NTP „Bursa Konfeksion” në Vushtrri, e ngritur falë

kontributit të bashkëatdhetarit nga Turqia **Rexhep Gyndyz** që është përkrahur dhe koordinuar me Drejtorinë e Arsimit.

SHMP „Bahri Haxha” posedon edhe tri serra të mëdha dhe një pemishte ku nxënësit i zhvillojnë praktikat profesionale.

SHMP „Lutfi Musiqi” në Vushtrri - Ka bashkëpunim me 14 ndërmarrje ku 141 nxënës zhvillojnë praktikë profesionale, po ashtu bëjnë vizita edhe në Kombinatin „Trepça” në Stan Tërg.

Duke e ditur se praktikat profesionale nëpër ndërmarrje ofrojnë një mjedis të fort dhe me cilësi të lartë të nxënësve, nxënësit kanë mundësi të përfitojnë shkathtësi praktike me pajisje moderne dhe nën kujdesin e trajnerëve të njohin shumicën e metodave dhe teknologjive më të fundit të punës. DA së bashku me shkollat do të punojnë që të rrisin bashkëpunimin edhe më shumë me ndërmarrjet punuese ku do të përfshihet numër më i madh i nxënësve.

Numri i nxënësve

Në vitin e ri shkollor 2014-15 në kalsën e parë janë regjistruar 1211 nxënës. Në krahasim me vitin e kaluar numri i nxënësve është më i madh për 76 nxënës.

Në klasat e dhjeta (X) janë regjistruar 1090 nxënës: Në krahasim me vitin e kaluar, numri i nxënësve në shkollat e mesme të larta në klasat e dhjeta (X) është për 147 nxënës më i vogël. Këtë vit shkollor ka rënie të numrit të nxënësve edhe për faktin se janë larguar klasat e XIII-ta.

Në fillim të vitit shkollor 2014 – 15 (shtator), janë regjistruar 15657 nxënës, nga të cilët, 766 nxënës janë në nivelin parafillor. Nëse i heqim parafillorët, numri i nxënësve nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë është 14891.

Shkolla e ulët e muzikës “Tefta Tashko”, paralelja e ndarë Vushtrri

Gjatë këtij gjysëmvetori në shkollën e muzikës në Vushtrri kanë ndjekur mësimet 80 nxënës, përkatësisht 4 klasë. Numri i nxënësve nëpër klasa është: Klasa e parë - 27 nxënës, klasa e dytë 19 nxënës, klasa e tretë 11 nxënës, klasa e katërt 23 nxënës.

Shkollat serbe

Procesi mësimor në gjuhën serbe zhvillohet në 5 shkolla (4 shkolla fillore dhe 1 shkollë e mesme). Shkollat në të cilat i vijnë mësimet komuniteti serb janë: Shkolla fillore “Sveti Sava” – Gracë, shkolla fillore “21 Nëntori” – Gojbulë, shkolla fillore “21 Nëntori” – Banjskë, shkolla fillore “Vuk Karaxhiq” – Prelluzhë, Shkolla e Mesme Teknike “Nikolla Tesla” – Prelluzhë. Në kuadër të Drejtorisë së Arsimit është një koordinatore e komunitetit serb, e cila koordinon punët e shkollave serbe me Drejtorinë e Arsimit.

Shëndetësia

Drejtoria për Shëndetësinë dhe Përkujdesje Sociale, në pajtim me përgjegjësitë dhe kompetencat e saja të bazuara në legjislacionin në fuqi përmes punës dhe angazhimit sistematik, ka krijuar kushte dhe mundësi për shërbime shëndetësore sa më të mira dhe sa më cilësore për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Në synimin për shërbime shëndetësore sa më cilësore janë bërë përpjekje që përmes investimeve kapitale, kuadrove profesionale dhe bashkëpunimit profesional dhe institucional të arrijmë standardin më të mirë të shërbimeve shëndetësore.

Mbrojtja shëndetësore e popullatës në komunën tonë sigurohet përmes kujdesit parësor dhe dytësor. Duke qenë se kujdesi dytësor është në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë, ky raport përfshin punët dhe aktivitetet që janë kryer në kuadër të kujdesit parësor shëndetësor në komunë.

Kujdesi Parësor Shëndetësor funksionin e vet e kryen nëpërmjet rrjetit të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve, të cilat kanë shtrirje në aspektin gjeografik për të ofruar shërbime të arritshme dhe gjithpërfshirëse për qytetarët.

QKMF funksionin e vet e ka kryer përmes këtyre shërbimeve: Shërbimit të mjekësisë familjare (QMF, AMF), shërbimit të diagnostikës (rëntgenit dhe laboratorit), shërbimit të stomatologjisë, shërbimit të vaksinimit, shërbimit të farmacisë, shërbimit të administratës dhe financave, shërbimit të higjienës, shërbimit teknik dhe shërbimit të transportit të pacientëve (auto-ambulancat).

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, detyrat e veta i ka kryer duke bashkëpunuar ngusht me: DSHMS, Spitalin “Sheikh Zayed” Vushtrri, IRSHP QZHM në Prishtinë, donatorët e jashtëm dhe Ministrinë e Shëndetësisë.

Kujdesi primar shëndetësor gjatë vitit 2014 ka ofruar shërbime shëndetësore për 150.886 pacientë (si numër i përgjithshëm përfshin edhe përsëritjen e vizitave të pacientëve), në detaje sipas të dhënave nga QKMF, kurse shërbimet e ofruara përfshijnë: vizita, konsultime nga mjekët familjarë dhe stomatologë, shërbimet emergjente 24 orë, urgjenca, terapi të infuzioneve dhe parenterale, si dhe vaksinimi. Këshillimorja për planifikim të familjes, këndi i rehidritimit, inhalimi, lidhëtorja, laboratorit, rëntgeni, rtg. e dhëmbit, nxjerrje dhëmbi dhe bllobim. Gjithashtu janë dhënë edhe udhëzime për sektorin dytësor në Vushtrri dhe Mitrovicë, si dhe në tretësor në Prishtinë.

1. Numri i pacientëve insulin-vartës është 513, prej tyre 8 janë fëmijë.

Pacientët të cilët janë të varur nga insulina pajisen në vazhdimësi nga QKMF-ja, më të gjitha llojet e insulinave dhe vonesat e furnizimit me insulinë nga MSH-ja janë shumë të rralla dhe në perioda shumë të shkurta, mund të regjistrohen vonesa ditore.

2. Numri i sëmundjeve malinje është 41, të raportuar nga mjekët në I.R.Sh.P.

Pacientët të cilët vuajnë nga sëmundjet malinje trajtohen në nivele të tjera të specializuara për këto sëmundje, dhe në rast të gjendjes së rëndë ekonomike të pacientëve mbështeten edhe nga DSHPS-ja me mjete financiare në shuma të vogla.

3. Numri i pacientëve në dializë është 19, dhe shërbimet i marrin në repartin e dializës në SR të Mitrovicës. Shërbimet për pacientë dhe bartjen e tyre e kryejnë punëtorët e QKMF-së.
4. Numri i sëmundjeve kronike është 219 të raportuara nga mjekët në I.R.Sh.P, ndërsa numri i sëmundjeve ngjitëse: 5.210 (akute dhe kronike).

Gjatë vitit 2014 sipas IKSHPS-së në Mitrovicë, raste të sëmundjeve ngjitëse me Incidencë në Komunën e Vushtrrisë janë si në vijim:

Komunat	ITPR Pneumonia	Diarea acute	Varicela	Influenca	Gjithsej
VUSHTRRI	754	3407	261	530	4952

Ecuria e sëmundjeve ngjitëse të sëmundjeve të grupit të dytë sipas IKSHPS-së në Komunën e Vushtrrisë është si në vijim:

Sëmundjet	VUSHTRRI
Sëmundjet infektive / Sindromet	
Mononucleozis infektiva	1
Dyshimi në meningjtin serioz	2
Sindromi i verdhëzës akute	1
Hepatitis B chronic	2
Dyshimi në parotitin epidemik	82
Tularemia	27
Intoxicatio alimentaris	4
TBC	31
Herpes zooster	12
Ictus ixodes	91
Dermatomycozis	3
Infeksionet transmissive seksuale	2
Gjithsej	258

Sindromi meningeal-meningiti sero

Janë regjistruar 10 raste në Komunën e Vushtrrisë. Ky numër është më i ulët sesa gjatë vitit paraprak ku ishin regjistruar 13 raste.

- Verdhëza acute A

Hepatiti viral A është lajmëruar në Vushtri 1 rast.

- Hepatitit B

Në Vushtri janë regjistruar 2 raste.

- Sëmundjet vaksinë preventabile

Epidemia e Parotitit po vazhdon edhe gjatë vitit të ri ku deri më tani janë regjistruar në Vushtri 82 raste.

- Influenca sezonale ILI dhe Influenca Pandemike AH1N1.

Gjatë vitit 2014 janë regjistruar në Vushtri 530 raste. Deri më tani nuk kemi pasur asnjë rast të konfirmuar në gripin pandemic AH1N1. Jemi në kontakt me Departamentin e Epidemiologjisë dhe jemi vigjilent për rastet e dyshimta në AH1N1 ku raportohet në mënyrë të rregullt. Vaksinat kundër Influencës

sezonale kanë arritur me kohë dhe vaksinimi me këtë vaksinë është kryer sipas indikacioneve epidemiologjike.

Vaksinimi

Edhe këtë vit sukcesi i vaksinimit është i kënaqshëm: Fëmijët deri 1 vjeç, vaksinimi ka qenë 96%, Fëmijët 2 vjeç sukcesi ka qenë 102 %, kl.I-rë, 100%, kl.VI-të,100%, viti i IV-të shkolla e mesme, 100%.

DSHPS ka shpërnda ndihmë momentale dhe mbështetje financiare për familjet në nevojë nga buxheti komunal, prej kategorisë së subvencioneve dhe prej bashkëpunimit që kemi pasur me organizata të ndryshme humanitare.

Ndihmë momentale dhe mbështetje financiare nga buxheti komunal kanë përfituar 176 familje.

Ndihmë në ushqim kanë përfituar 284 familje.

Nga subvencionet për strehim kanë përfituar 18 familje.

Po ashtu si DSHPS në bashkëpunim me organizata të ndryshme humanitare kemi mbështet familjet në nevojë edhe me ndihma si:

1. Veshmbathje për 200 familje.
2. Mjete financiare në vlerë prej 30 euro për 110 familje.
3. Pako ushqimore për 200 familje,
4. Mish viçi për 100 familje.

Qendra për punë sociale

Në kuadër të veprimtarisë së vet profesionale, qendra: Zbulon dhe përcjellë nevojat dhe problemet sociale të qytetarve ; zbulon familjet në gjendje të vështirë materiale dhe zbaton formën e ndihmës sociale në kuadër të kriterëve të përcaktuara me ligj; propozon, organizon dhe ndërmer masa në aplikimin e formave adekuate të mbrojtjes sociale dhe ofrimit të shërbimeve sociale; inicon, organizon dhe koordinon punën profesionale dhe vullnetare në lëmin e mbrojtjes sociale; mban kontakte dhe bashkëpunon me OJQ dhe institucione që kanë fushëveprimin e mbrojtjes sociale.

Dinamika – lëvizja e numrit të shfrytëzuesve dhe realizimi i formave të mbrojtjes sociale

Grupacioni	Viti raportues	Viti paraprak	Indeksi
Fëmijë dhe rini	3.390	3.571	0.9
Të rritur	4.739	4.756	0.9
Të moshuar	122	159	0.8
Gjithsej	8.251	8.486	0.9

Në periodhën raportuese mund të themi se kanë ardh në shprehje maksimale të gjitha grupmoshat të shprehura përmes kategorive të ndryshme të mbrojtjes sociale dhe janë ofruar shërbime apo forma adekuate të mbrojtjes sociale. Nga vet pasqyra tabelare mund të konstatohet se krahasuar me vitin paraprak kemi një ndryshim të lehtë të shërbimeve dhe të kategorive të ndryshme të mbrojtjes sociale.

Asistenca sociale

Pasqyra tabelare e shfrytëzuesve të asistencës sipas grupmoshës

VITI RAPORTUES					VITI PARAPRAK				Indeksi
Asistenca Sociale	Fëmijë dhe te rinj	Të rritur	Pleq	Gjithsej	Fëmijë dhe rini	Të rritur	Pleq	Gjithsej	
	2993	3541	112	6646	4191	4331	149	8671	0.74

Pasqyra tabelare e shfrytëzuesve sipas kategorive

	Viti raportues			Viti paraparak			Indeksi
	Aplikant (familje)	Anëtar	Gjithsej	Aplikant (familje)	Anëtar	Gjithsej	
I	831	2910	3741	706	4074	4780	0.96
II	689	2216	2905	879	3012	3891	0.93
Gjithsej	1520	5126	6646	1585	7086	8671	0.74

Gjatë kësaj periode, në komision mjekësor janë dorëzuar dhe trajtuar 934 aplikantë. Prej tyre janë aprovuar nga KM. 612 raste, kurse janë refuzuar 315, ndërsa në rishqyrtim kanë qenë 7. Gjatë kësaj periode janë verifikuar dhe riverifikuar 1263 familje.

Shërbimet sociale

Në periodën raportuese krahasuar me vitin paraparak, numerikisht numri i klientëve ka pasur ngritje si rezultat i trajtimit të kategorive të reja, dhe e gjithë kjo ka rezultuar edhe me rritjen e volumit të punëve dhe ofrimit të shërbimeve përmes formave të mbrojtjes sociale. Të gjitha këto konkretizohen përmes shënimeve si në vijim:

VITI RAPORTUES	<i>VITI PARAPRAK</i>
-----------------------	----------------------

Format dhe shërbimet e mbrojtjes sociale	Fëmijë dhe rini	Të rritur	Pleq	Gjithsej	Fëmijë dhe rini	Të rritur	Pleq	Gjithsej	Indeksi
Vendosja në institucione	10	7	1	18	7	7	4	18	1
Strehimi familjar	32			32	39			39	0.8
Vendosja në familje tjetër	2			2	1			1	2
Aftësimi për punë		7		7					
Kujdestaria	60	3		63	63	1		64	0.9
Shërbimet e punës sociale	293	1181	9	1483	270	1057	6	1333	1.11
Gjithsej	397	1198	10	1605	380	1065	10	1455	1.10

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periode ka pasur 29 raste të trajtimit të bashkëshortëve me marrëdhënie të çrregulluara ose në procedurën e shkurorëzimit, ku prej tyre është arrit: përmirësim i marrëdhënieve në 3 raste, 5 raste janë në trajtim e sipër, ndërsa 21 raste janë shkurorëzuar e që kryesisht sikurse edhe vitin paraprak janë shkurorëzime me marrëveshje me përjashtim të 7 rasteve.

Nga këto familje janë 21 fëmijë, prej tyre 13 i janë besuar nënës në kujdesje, ndërsa 8 iu janë besuar babës në përkujdesje. Shkurorëzimi me marrëveshje është bërë një dukuri për shkak të rregullimit të dokumentacionit në botën e jashtme, (kurorëzimi me persona nga bota e jashtme) e që bëhet me marrëveshje mes dy bashkëshortëve, mirëpo ka raste kur një veprim i tillë bëhet realitet dhe vjen deri te ndarja faktike. Në QPS ka edhe 8 kërkesa prej gjykatës për shkurorëzim, të cilat do të barten në vitin tjetër.

Fëmijët pa kujdes prindëror

Qendra në këtë periudë, detyrë prioritare ka pasur punën me fëmijët pa kujdes prindëror dhe në përgjithësi fëmijët nga familjet devijente. Është bërë evidentimi i këtyre fëmijëve, hapja e dosjeve dhe përpunimi profesional i kësaj kategorie është në përfundim e sipër, si dhe punë permanente.

Fëmijët	Viti raportues	Viti paraprak	Indeksi
jetim (pa dy prindërit)	6	6	1
Fëmijë të braktisur	33	37	1
Fëmijë me prindër të zhdukur	18	23	1
Të prindërve të penguar ta kryejnë të drejtën si prind			
E prindërve që nuk e kryejnë	1	1	

detyrën prindërore			
Gjithsej	58	67	0.8

Format dhe masat e aplikuara të mbrojtjes sociale

Forma dhe masa	Viti raportues	Viti paraparak	Indeksi
Kujdestaria	60	67	0.8
Kujdestaria e vaçantë	3	1	3
Adoptimi	4	2	0
Strehimi familjar për foshnja (beba)	2	2	2
Strehimi familjar me pagesë	32	32	1.0
Strehimi në SOS Kinderdorf	4	3	1.3
Ndihma sociale			
Ndihma në natyrë			
Shërbimet tjera	2130	1125	1.8
Gjithsej	2239	1221	1.8

Të miturit me sjellje të çrregulluara dhe delikuentë të mitur

Të miturit	Viti raportues	Viti paraparak	Indeksi
Të miturit me sjellje asociale	6	2	1.0
Të mitur delikuentë	15	10	1.0
Të miturit në kundërshtim me ligjin	30	17	1.0
Gjithsej	51	29	1.0

Siç shihet nga tabela kemi rritje të gjendjes së delikuencës të të miturve. Kjo gjendje rezulton për shkak të trajtimit të të miturve delikuent rezulton si pasojë e trajtimit dhe përpunimit të rasteve nga ana e Shërbimit Sprovues të Kosovës, i cili tani e tutje i përpunon këto raste, pra dhënien e mendimeve, gjykatave, ndërsa ne i trajtojmë edhe më tutje në aspektin e mbikqyrjes. Në këtë drejtim me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira në procesin e risocializimit dhe riedukimit kemi pasur bashkëpunim të drejtëpërdrejt me policinë, familjen, Shërbimin Sprovues të Kosovës dhe subjekte tjera.

Viktima të trafikimit dhe tentim dhunimit

Gjatë periodës raportuese nuk kemi pasur raste të personave të dyshuar për trafikim, si dhe as raste të abuzimit seksual.

Dhuna familjare

Janë evidentuar 9 raste të raportimit të dhunës familjare, çka është mjaft brengosëse kur të kemi parasysh se rastet po shtohen dhe ekipet e qendrës për punë sociale ju ofrojnë asistim në polici, vendosje në strehim të përkohshëm, kurse ekipet kanë nevojë për trajnime, rreth trajtimit të këtyre rasteve.

Personat e moshuar

Kategoria	Viti raportues	Viti paraprak	Indeksi
Pa kujdes familjar	10	7	1.4
Të sëmurë psiqik	8	3	2.6
Gjithsej	18	10	1.8

Vlenë për t'u theksuar se në Qendrën për Punë Sociale janë 57 familje minoritare shfrytëzues të ndihmës sociale, prej tyre 39 familje serbe, 9 rome, 6 familje ashkalinj, 1 turke dhe 2 boshnjake - muslimane. Prej tyre familjet serbe dhe rome trajtohen nga nëpunësi minoritar që është një punëtor i ndihmës sociale, ndërsa ashkalinjtë, boshnjakët e të tjerët trajtohen nga punëtorët shqiptarë këtu në QPS. Trajtimi i tyre bëhet pa kurrfarë paragjykimi dhe me profesionalizëm të lartë.

Qendra për Punë Sociale ka edhe një nënzyre në Prelluzhë ku punon një punëtor serb, në kuadër të mundësive që i ka, të njëjten e ka pajisur me inventar dhe gjëra tjera të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë në suaza normale.

Mbrojtje dhe shpëtim

Gjatë këtij viti kalendarik ndër të tjera janë zhvilluar edhe këto aktivitete: Kontakti i rregullt me Qendrën Rajonale në Mitrovicë për menaxhimin e emergjencave; kontrollimi i rregullt i radiolidhjeve dhe mjeteve për komunikim; evidentimi dhe përcjellja e informatave për ngjarjet në terren; montimi dhe mbikëqyrja e funksionimit të kamerave vëzhguese në qytet dhe në objektin e komunës; azhurnimi, freskimi dhe plotësimi i dokumentacionit relevant për mbrojtje dhe shpëtim si: Vlerësimi i rrezikshmërisë për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës; Plani i përgjithshëm për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera; Plani për mbrojtje nga fatkeqësitë e zjarrit (sipas situatave në terren); Plani për evakuimin në raste emergjente (sipas situatave në terren); Plani komunal për reagim emergjent; Plani për reagim emergjent në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në ndërtesën e komunës.

Në vitin 2014 në komunën tonë kanë ndodhur disa fatkeqësi natyrore dhe teknologjike si:

1. Janë evidentuar 611 fatkeqësi nga zjarri, të cilat nuk kanë qenë të natyrës së rëndë, dhe të cilat për pasojë kanë pas dëme të konsideruara materiale.
2. Disa tërmete të intensitetit të ulët me epiqendër në verilindje të komunës.
3. Vërshime dhe stuhi të forta të përcjellura me shi dhe breshër.
4. Erëra të forta ku për pasojë kishte sjell dëmtimin e shumë pullazeve të shtëpive.
5. Fatkeqësi teknologjike, të cilat kryesisht kanë qenë në trafik.

Si rrezik i mundshëm teknologjik ka paraqit mospuna në Fabrikën e Llamarinës “LLAMKOS CORE GRUP”, ku nuk kanë qenë nën mbikëqyrje rezervuarët e gazit të lëngëzuar të naftës dhe rezervuarët e

amoniakut. Në muajin qershor 2014 drejtori menaxhues i Fabrikës së Lllamarinës “Llamkos Core Grup” ka kërkuar për t’i dalë në ndihmë lidhur me ftohjen e rezervuarve – enëve nën presion që përmbajnë amoniak dhe gas LPG. Për t’i ikur ndonjë katastrofe eventuale është mobilizuar një ekip të zjarrfikësve ku çdo ditë kanë intervenuar për ftohjen e këtyre rezervuarve. Është bërë njoftimi i menjëhershëm i të gjitha organeve kompetente në nivelin qendror. Lidhur me rastin janë mbajtur takime me përfaqësues të KEDS-it, KFOR-it etj., derisa ka ardhur te zgjidhja e problemit.

Për shkak të thatësisë gjatë sezonit veror janë furnizuar me ujë teknik disa familje të fsh. Dumnice, Sfaracak, Studime dhe Akrashtice.

Në muajin prill pas intensitetit të shiut që ra pa ndërpre kemi ngrit gjendjen e gatishmërisë emergjente. Në kuadër të masave që u ndërmorrën, fillimisht u dha urdhëresë që stafi përkatës të angazhohet 24 orë pa ndërpre derisa të zgjasë kjo gjendje ku u ndërmorrën këto veprime dhe masa: U formua ekipi mobil shëndetësor për intervenim emergjent në terren për raste të sëmundjeve të ndryshme; u koordinuan aktivitetet edhe me Policinë e Kosovës në Vushtrri, e cila ka ndihmuar për menaxhim më të mirë të situatës në terren, si dhe Njësinë e zjarrfikësve e cila gjithashtu është angazhuar me mekanizmin përkatës për t’u dalë në ndihmë ekipeve në terren, kurse përmes medieve është bërë informimi dhe apeli tek qytetarët që të kanë kujdes gjatë kësaj situatë dhe të përcjellin gjendjen dhe të marrin masat e sigurisë për çdo të papritur që mund t’ju ndodh; është marrë vendim që familjeve që janë evakuuar nga shtëpitë e tyre dhe atyre që janë të izoluar t’u ndihmohet me gjëra ushqimore dhe sanitare në vlerë prej 40 (dyzetë euro).

Është marrë qëndrim që komfor situatës dhe gjendjes së krijuar në terren të angazhohen kompani adekuatë për debllokim e lumenjve, kanaleve dhe rrugëve të bllokuara si pasojë e reshjeve atmosferike. Gjatë kësaj situatë i kemi angazhuar disa kompani për intervenim në terren, u koordinuan aktivitetet me Kryqin e Kuq në Vushtrri, është vendosur kontakt i vazhdueshëm me Qendrën për Emergjencë në nivel regional, Zyra për informim u obligua që të informojë opinionin për masat që po ndërmerren, si dhe mundësitë që qytetarët të kenë qasje të pandërprerë me ekipin emergjent të komunës.

Vendbanimet më të goditura nga kjo situatë ishin: Pestova, Nadakoci, Maxhunaj, Stanoci i Epërm, Stanoci i Poshtëm, Lumadhi, Prelluzha, Sllakoci, Cecelia, Samadrexha, Ropica, Vilanci, Dumnica e Poshtme, Studinja, Sllatina, Mihaliqi, Druari, Rezniku, Vërrnica, Novolani, Begaj, si dhe pjesa perëndimore e qytetit të Vushtrrisë.

Si pasojë e vërshimeve, dy familje me gjithsej 13 anëtarë (8+5) në Stanoc janë evakuuar tek të afërmit e tyre, ndërsa me dt. 20.04.2014 familja e Kumrije Dervishit me 10 anëtarë në fsh. Nadakoc është izoluar nga uji. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim për këto tri familje ka dërguar pako ushqimore dhe higjienike, dyshekë dhe batanije. Po ashtu edhe në fshatin Prelluzhë disa shtëpi kanë qenë përkohësisht të izoluar por që falë intervenimit të ekipit emergjent kjo situatë u normalizua pas hapjes së kanalit në rrugë që shpie në fshat. Për të gjitha këto familje u shpërnda ujë i pijes, ndërsa për ushqime nuk kanë pasë nevojë. Si pasojë e ndotjes së ujit të pijes shumë familje kanë kërkuar furnizim me ujë në ç’rast Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka shpërndarë 125 bidonë me ujë në fshatrat; Stanoc, Pestovë, Lumadh, Nadakoc dhe Prelluzhë.

DMSH-ja duke u bazuar në gjendjen e krijuar në terren ka angazhuar disa kompani në të gjitha pikat ku ka mundur të ketë vërshime dhe ka eliminuar rrezikun nga vërshimet.

Nr. Rend.	Emri i kompanisë Intervenuese	Orë pune	Çmimi për orë pune	Shuma në euro
1	NNPP "HYSNIA"	24 orë	85,00	2040,00
2	NN "KOPSHTI"	3 orë	85,00	255,00
3	NP "12 VËLLEZËRIT"	5 orë	80,00	400,00
GJITHSEJ:				2.695,00

NN “RRUKOLLI”, NP “VENDA”, si dhe KU” “Ujësjellësi Regjional” dhe KRM ”UNITETI”. Të gjitha angazhimet në terren i kanë realizuar në mënyrë vullnetare. Po ashtu në tërë këtë situatë vazhdimisht ka qenë e angazhuar edhe Brigada e zjarrfikësve, ndërsa më datë 30.07.2014, rreth orëve të mbrëmjes, Vushtrinë me rrethinë e përfshiu një mot i lig i përcjell me stuhi, shi, breshër përcjell me shprazje atmosferike në pjesën lindore të qytetit: Studime e Poshtme; Ceceli; Begaj; Gojbulë; Miraçë; Karaçë, Nadakoc ku kishte 4 të lënduar lehtë. Në këtë mot të lig janë përfshi edhe shumë pullaze të shtëpive të dëmtuara, disa të demoluara tërësisht dhe disa me dëme tjera materiale.

Gjithashtu edhe më datë 18.11.2014 dhe 02.12.2014, mot i lig përfshiu tërë territorin e komunës, ku si pasojë e sasisë së ujit të krijuar nga shiu shumë lagje, fshatra, rrugë dhe prona bujqësore u përmbytën nga uji, si: Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim së bashku me ekipet shpëtimtare të zjarrfikësve gjatë gjithë kohës kanë qenë në terren dhe ndërmorrën një sërë aktiviteteve përmes kompanive të ndryshme për evitimin e rrezikut dhe minimizimin e pasojave.

Njësia e zjarrfikësve: Rastet e intervenimeve: zjarre - 372, intervenime teknike - 201, vërshime – 26, aksidente rrugore – 5, gjithsej - 612 intervenime, ndërsa ka pas 7 lajme të rrejshme.

Janë angazhuar gjithsej 1329 zjarrfikës me 1566 orë pune, si dhe 629 automjete zjarrfikëse me 743 orë pune.

Inspektori i parandalimit: Janë kryer 55 inspektime, prej tyre inspektim fillestar-3, inspektime të rregullta -50, të jashtëzakonshëm -2.

Drejtoria së bashku me inspektorin e preventivës ka bërë inspektimin e të gjitha shkollave fillore dhe të mesme, si dhe objektit të komunës mbi gjendjen e aparaturave për fikjen e zjarrit dhe ka propozuar masa të nevojshme për servisimin, rimbushjen dhe furnizimin me aparate të nevojshme për zjarrfikje në të gjitha objektet e lartshënuara. Të gjitha këto masa në mënyrë të specifikuar janë dërguar Drejtorisë për Arsim.

Inspektimet

Drejtoria për Inspektime - Vushtri gjatë kësaj periudhe aktivitetet e veta i ka përqendruar në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë dhe akteve tjera nënligjore me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për rend dhe rregull në të gjitha fushat në Komunën e Vushtrisë.

Në kuadër të drejtorisë veprojnë inspektoratet e lëmvive si vijon:

Inspektorati i tregut – Masat dhe aktivitetet: Kontrolli i regjistrimit të bizneseve, kontrolli për vendosja e çmimeve, mbajtjen dhe azhuretetin e librave në subjekte afariste, kontrollimi i dhënies së kuponave (faturave) blerësve, udhëzimet teknike dhe garancionet e mallrave, si dhe saktësia e dokumentacionit përcjellës etj., rrespektimin e orarit të punës, kontrollimin e deklaratave të mallrave, Inspektimi i kushteve teknike të subjekteve afariste tregtare që merren me shumicë dhe pakicë dhe subjektet shërbyese etj. Inspektime të Operatorëve ekonomik të cilët merren me shitjen - tregtimin dhe përpunimin e metaleve të çmueshme dhe nga të njëjtit të kërkohet edhe Vendimi për ushtrimin e veprimtarisë dhe për përcaktimin e madhësisë, përdorimin e shenjës identifikuese (foto, vula dhe vula identifikuese, të cilat janë të punuara nga metali), të cilat vendime i nxjerr Departamenti i Metrologjisë së Kosovës (DMK) në Prishtinë, deklaracioni i mallit, faturat hyrëse, dalëse, kontrollimi i shitësve ambulantë dhe dokumentacionin përcjellës.

Inspektorati sanitar - Masat dhe aktivitetet: Inspektimi i të gjitha subjekteve të cilat merren me shërbime, librezat sanitare, mallrat me afat të skaduar, ekspozimet e mallrave jashtë dyqanave, uniformat e punës.

Inspektorati i ndërtimtarisë - Masat dhe aktivitetet: Lejet e ndërtimit, legalizimet e objekteve, vendosja e pikave ndërtimore.

Inspektorati i komunikacionit - Masat dhe aktivitetet: Inspektimi i transportuesve taxi, kombibusave, autobusëve, kontrollimi i transportuesve tjerë që merren me transportimin e mallrave të ndryshme.

Inspektorati i veterinarisë - Masat dhe aktivitetet: Inspektimi i thertoreve, mishtoreve, kontrollimi i produkteve tjera me prejardhje shtazore, certifikimi i produkteve të mishit.

Inspektorati i mjedisit, Inspektorati i shërbimeve publike, Inspektorati i higjienës - Masat dhe aktivitetet: Mbikqyrja dhe mbarëvajtja e hedhurinave, pastrimi i rrugëve rreth qytetit, inspektimi rreth ekspozimit të mallrave, ruajtja e ambientit dhe mjedisit hapësinor.

Inspektorati	Nr.i procesverbaleve	Fletëparaqitje	Aktivendime / udhëresa	Mbyllje të lokaleve përkohësisht	Gjjoba mandatore	Vlera e gjjobave mandatore
Inspektorët e tregut	680	12	32	6		
Inspektori sanitar	208	15	58	2		
Inspektorët e ndërtimtarisë	98	27	67			
Inspektorët e komunikacionit	198	4				
Inspektori i veterinarisë	231	4				
Inspektori i mjedisit	76	2	82		8	130,00 €
Inspektorja e higjienës	23		109		3	100,00 €
Totali	1514	64	348	8	11	230,00 €

Subjektet afariste që kanë plotësuar kushtet minimale teknike - Inspektorati i tregut

Aplikuar	146
Të vendosura	146
Mjete të inkasuara në €	5810,00 €

Pranime teknike nga automjetet - Inspektorët e komunikacionit

Aplikuar	48
Të vendosura	48
Mjete të inkasuara në €	240,00 €

Pëlqime sanitare - Inspektori sanitar

Aplikuar	50
Të vendosura	50
Mjete të inkasuara në €	4772,69 €

Gjoha mandatore të aplikuara nga ana e Inspektoratit

Të aplikuara	6
Të vendosura	6
Mjete të inkasuara në €	230,00 €

Malli i larguar nga shitja dhe qarkullimi dhe mall i asgjësuar nga Inspektorati i tregut dhe sanitar

Mall i asgjësuar, vlera në euro	50157.08 €
Mjete të inkasuara nga asgjësimi i mallrave	1420,00 €

Largimi, rrënimi i objekteve pa leje ndërtimi - Inspektorët e ndërtimit

Largim i objekteve të përkohshme – kiosqet nga prona komunale	21
---	----

Të hyra nga Inspektorati i komunikacionit - Pranimi teknik i automjeteve

Pranime teknike të automjeteve	48
Totali në euro	240,00 €

Të hyra nga Inspektorati veterinar

Certifikata shëndetësore të therjes	1049	5273,15 €
Certifikatë e origjinës së produktit	462	
Certifikatë transporti	1	7,00 €
Certifikatë shëndetësore e kafshëve	Të llog. në %	81,00 €
Mostra ushqimi, kafshë të sëmura dhe të ngordhura	8	
Gjithsej të hyra		5361,15 €

Kultura, rinia dhe sporti

Shënimi i datave të veçanta:

- 25.01.2014 Shpallja e sportistëve të dalluar të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2013.
- 31.01.2014 Homazhe në rastin e datës të rënies së dëshmorit Zahir Pajaziti.
- 17.02.2014 Manifestimi i 6 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.
- 18.02.2014 Manifestimi i 6 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, përparitur nga Kopshti i fëmijëve “LUMTURIA”
- 24.03.2014 U shënuar 68 vjetori i hapjes së bibliotekës “Naim Frashëri”.
- 16.04.2014 Shënimi i “Javës së Biblioteksës të Kosovës” në Vushtri.
- 17.04.2014 Aktivitet në rastin e javës së bibliotekës.
- 18.04.2014 Dita e Trashëgimisë.
- 23.04.2014 Dita Ndërkombëtare e Librit.
- 02.05.2014 Akademi përkujtimore për të rënë në fshatin Studime, më 2 majin e vitit 1999.
- 10.05.2014 Akademi përkujtimore e dëshmorit të kombit Hamdi Ferati.
- 22.05.2014 Akademi përkujtimore kushtuar martirëve të vrarë në masakrën e Vushtrrisë 1999.
- 22.05.2014 Akademi kushtuar dëshmorit Blerim Zuçaku.
- 01.05.2014 Shpallja kampion e Klubit të Futbollit “Llambas Kosova”.
- 17.06.2014 Dita e çlirimit të qytetit të Vushtrrisë.

Të arriturat e Ansambllit “Hasan Prishtina”:

- “Hasi Jehon”, Lidije Pasoma merr çmimin “Nazmije Hoxha”.
- Festivali Ndërkombëtar - Viti, Dueti Enver Haliti dhe Egzona Meniqi shpallen solistët më të mirë të festivalit, si dhe komplet ansambli merr vendin e parë.
- Festivali Gjilan, Enver Haliti dhe Egzona Meniqi marrin vendin e parë, si dhe orkestri shpallet më i sukseshmi për kultivimin e muzikës shqipe.
- Festivali Kastriot (Obiliq) Egzona Meniqi shpallet pa konkurrencë solistja më e mirë e festivalit.
- Festivali Dejn - Rahovec, dyshja e vallëtarëve Berna Kera dhe Veton Bozhani shpallen si vallëtarët më të mirë të festivalit, si dhe ansambli zë vendin e dytë.

- Festivali ndërkombëtar Ankara - Turqi, vallëtarët e ansamblit marrin vendin e dytë.

Themelimi i “Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë”. Teatri i cili funksiononte tash e sa vite, nuk ekzistonte në asnjë dokumentacion si teatër i themeluar. Me propozim të DKRS-së përmes Kryetarit të Komunës, bazuar në Ligjin për Teatrot u bë themelimi e më pas dhe konsolidimi i teatrit të qytetit.

Subvencione për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive

- KSH “Llamkos”. Për organizimin e turnirit tradicional të Shahut për nder të 2 Majit, masakrës së Studimes.
- OJQ Forca. Janë ndarë 480 € për kërkesën që kanë shtruar për koreografinë në rastin e shpalljes kampion të „Llamkos Kosovës“, ndërsa 1000 € janë ndarë me propozim të Kuvendit Komunal për të vazhduar festën
- KF “Kosova”. Përmes Kuvendit janë ndarë me propozim të Kryetarit të Komunës si subvencionim shtesë i lojtarëve të Klubit, i cili në ato ditë para shpalljes kampion ishte në krizë.
- KB „Vushtrria Basket“. Organizimi i Turnirit të Basketit me moshën U-12 për nder të 1 Qershorit - Ditës së Fëmijëve. Në këtë turnir morën pjesë klube basketi nga gjithë Kosova.
- SHPKF SSH. Subvencionim i Shoqatës së Pedagogëve të Kulturës Fizike, për të vizituar qendra sportive nëpër qytete të Kosovës. Kjo u bë e mundur falë rezultateve kulminante të të rinjve sportistë.
- Shoqatës së të shurdhërve. Për organizimin e turneut të futbollit në muajin shtator, me të gjitha Shoqatat e të shurdhërve të Kosovës.
- Subvencionim për turneun e futbollit për nder të „Ditës së Evropës“.
- K. Kikboxit “UKA”.
Për pjesëmarrje në garat Republikane e të Kikboxit.
- Dardan Mengjiqi.
Në rastin e shpalljes “Sportist i Vitit”.
- Për shfaqjen teatrale “Akrabatë“.
- “Eksodi 99”.
- OJQ “Star of Future”.
Për projektin “Dita e Tokës” sensibilizim për ditën e tokës.
- OJQ “Dardania“. Për projektin “Urat urëlidhëse mes vendeve dhe njerëzve”, për punimin e Urës së Gurit me maketë, punim ky që do të promovohet me 1 gusht në kuadër të ditëve të diasporës, ku Vushtrria do të ketë mundësi ta prezantojë anën historike dhe kulturore të saj në sheshin „Nëna Terezë“ në Prishtinë.
- OJQ “Kult Studio”. Për aktivitetin 1 Maji në Sllakoc. Aktivitet ky që mblodhi shumë të rinjë nga regjioni e më larg, qëllimi i të cilit ishte promovimi i bukurive natyrore të qytetit tonë, njoftimi me ato dhe zhvillimi i turizmit.
- OJQ “Hareja”. Aktivitet për „Ditën e Evropës“, debate dhe ligjërata të organizuara me të rinj.
- OJQ “Lëvizja Koha”. Për organizimin e Marshit të Pavarësisë në rastin e festës së pavarësisë.
- Kosova Turk Mili Bayrami. Komunitetit Turk për aktivitetin e tyre tradicional.
- OJQ “Lëvizja Koha”. Për Panairin e Shkencës dhe Kulturës, i cili kaloi në përmasa republikane e madje edhe jashtë saj.
- OVL “UÇK”. Për organizimin e tubimit tradicional për Zonën Operative të Shalës.
- OJQ “FASH”

Në bashkëfinancim me dy komuna tjera dhe me Ministrinë e Diasporës, është bërë printimi i 6000 broshurave me informata për qytetin e Vushtrrisë, printimi i mbi 6000 broshurave me fotografi të

atraksioneve që ofron Vushtrria (kryesisht objekte trashëgimore), të cilat janë shpërndarë në qytet, por mbi 90% e tyre në aeroportin e Kosovës.

Subvencione për botimin e librave

- Kadrie Meniqi “Shkollat shqipe në Çamëri gjatë viteve 1939-1945”. Libër kushtuar periudhës 1939-1945, vështirësive nëpër të cilat kaluan shkollat shqipe asokohe.
- Rajmonda Melecka “Mbollëm gjak, mbijnë këngë”. Libër kushtuar dëshmorëve të qytetit të Vushtrrisë.
- Nazmije Mema “Oaza e jetës”. Përmbledhje poezish.
- Habib Mustafa “Stroci gjatë historisë”. Libër i cili përmbledh tërë historinë e Strocit që nga periudha paraosmane deri në ditët e fundit. Pos anës historike shtjellohet edhe pozita gjeografike dhe bukuritë e këtij fshati.
- Bedri Tahiri “Toponimia e Galicës”.
- Liridon Miftari “Pikë shiu”. Përmbledhje poezish.
- Myrvete Osmani “Përmbledhje poezish”.
- Izet Miftari – përgatitja e temës së doktoraturës me titull „Rrethanat fetare dhe kulturore në Vilajetin e Kosovës nga gjysma e shek. XIX deri më 1912“, në kuadër të së cilës bën pjesë edhe Vushtrria.
- Dafina Musa “Përmbledhje poezish”.

Të arriturat në fushën e sportit

KLUBI I FUTBOLLIT “LLAMKOS KOSOVA”

-Kampion i Raiffaisen Superligës së Kosovës për edicionin 2013/14.

-Finalist i Digitalb Kupës për edicionin 2013/14.

-Fitues i Superkupës së Kosovës për edicionin 2013/14.

KLUBI I BASKTEBOLLIT “KOSOVA” FEMRAT

Klubi për herë të parë është inkuadruar në garat e ETC në Superligën e Kosovës. KBBF “Kosova” radhitet në vendin e nëntë;

KLUBI I BASKTEBOLLIT “Vushtrria Basket”

Klubi në gara në Teb Ligën e Juniorve, në fund të kampionatit 2013/14 në Play Off kanë arritur në finale, në ç’rast kanë pësuar nga ekipi i RTV 21.

*Klubi në gara në Teb Ligën e Kadetëve, në fund të kampionatit 2013/14 në Play Off kanë arritur në finale, në ç’rast kanë pësuar nga ekipi i RTV 21.

*Klubi në gara në Teb Ligën e Pionerëve, në fund të kampionatit 2013/14 në Play Off kanë arritur në finale, në ç’rast kanë fituar nga ekipi i RTV 21 dhe u shpallen kampion.

KLUBI I HENDBOLLIT “KOSOVA” - M. VUSHTRRI

Kanë arritur rezultat shumë të mirë duke u renditur në pozitën e tretë në tabelën e klasifikimit, duke siguruar edhe garat shtesë të PLAY OFF-it, në të cilat i kanë zhvilluar tri ndeshje, dy humbje dhe një fitore.

Sa i përket Garave për Kupën e Repulikës së Kosovës në edicionin pranveror kanë arritur në finalen e madhe që është organizuar në qytetin e Pejës. Në finale janë mposhtur nga “Besa Famiglia”.

Klubi i hendbollit “Kosova”-F Vushtrri

KHF “Kosova” gjatë edicionit të garave 2013/14 ka arritur në garat e Play offit, duke u radhitur në pozitën e dytë. Gjithashtu edhe në garat për kupën e Kosovës ky klub ka arritur gjer në finale ku ka pësuar disfatë nga KH “Kastrioti” - F nga Ferizaji.

KH "Kosova" - F Vushtrri si finaliste te Play Offit dhe finaliste të Kupës së Kosovës kanë fituar të drejtën që ta prezentojnë Republikën e Kosovës në gara ndërkombëtare.

Klubi i hendbollit "Samadrexha" – M. Samadrexhë

KH "Samadrexha" arriti rezultate me ekipin e pionierëve ku u stolis me titull të kampionit pasi që e mposhti "Besën" e Pejës.

Klubi i hendbollit "Samadrexha" – F. Samadrexhë

Ekipi i femrave pas dy viteve që u riorganizua dhe filloi garat në Ligën e Parë të Republikës së Kosovës, në edicionin pranveror u kurorëzua me titullin e kampionit në Ligën e parë të hendbollit kosovar e që në edicionin e garave 2014/2015 do të jetë anëtare e re e Superligës së Kosovës.

Klubi i volejbollit "Kosova"- F. Vushtrri

KV "Kosova"- F Vushtrri gjatë edicionit të garave 2013/14 ka garuar në Ligën e Parë të Kosovës. Në fund të kampionatit u radhit e para dhe fitoi të drejtën e garimit në Superligën e Kosovës në edicionin e garave 2014/15.

Klubi i volejbollit "As Vushtrria" - Vushtrri

KV "As Vushtrria" Vushtrri gjatë edicionit të garave 2013/14 ka garuar në Ligën e Parë të Kosovës. Në fund të kampionatit u radhit e para dhe fitoi të drejtën e garimit në Superligën e Kosovës në edicionin e garave 2014/15.

Klubi i volejbollit "Gjimnazisti" - Vushtrri

KV "Gjimnazisti" Vushtrri gjatë edicionit të garave 2013/14 ka garuar në Ligën e Parë të Kosovës. Në fund të kampionatit u radhit në pozitën e tretë. Në bazë të zgjerimit të Superligës së volejbollit fitoi të drejtën të garojë në Superligë.

Klubi i volejbollit "Vushtrria" - Vushtrri

Klub i ri i cili garon në Ligën e parë të volejbollit të Kosovës ku marrin pjesë 4 epike. Sezoni vjeshtor të kampionatit e mbylli në vendin e dytë me 6 pikë të tubuara, 3 pikë më pak se kryesuesi.

Klubi i Kickboxit "Uka" - Vushtrri

27.06.2014-Kampionati i Kosovës në Kickbox

Totali i medaleve: 2 të arta, 3 të argjendta dhe 3 të bronza.

Donacione

- Projekti "Koreografi e valles me motive nga Shala" 2000 €. Financuar nga MKRS, ky projekt ia mundësoi ansamblit të valles "Hasan Prishtina" që në repertorin e tij të shtojë edhe një koreografi të re, mundësi kjo që u dha falë garderobës së re që është blerë për ansambël.
- Projekti "Hapja e ekspozitës" 2000 €. Mbështetur nga MKRS. Ky projekt do të jetë në kuadër të Shkollës Verore të Artit. Qëllimi i tij ishte që të blinin mjete (të gjitha mjetet e nevojshme për pikturë) për dhënien e mundësisë së shfaqjes së talenteve të rinj, të cilët kanë prirje në art, por mungesë kushtesh apo edhe drojë për ta shfaqur veten. Ekspozita do të hapet në muajin shtator.
- Takimet e Poeteshave Shqiptare 4000 €. Mbështetur nga MKRS. Ky projekt ishte paraparë të zhvillohej në qershor, por në atë periudhë ishte fushata zgjedhore, e duke mos dashur t'i japim ngjyrimë politike artit të penës e shtymë këtë aktivitet.
- Projekti "Ta pasurojmë bibliotekën me libra" 2000 €. Mbështetur nga MKRS. Me këtë projekt, fituam donacion me libra në vlerë 2000 €.
- Rregullimi i stadiumit të qytetit "Ferki Aliu" 166.000 €. Mbështetur nga MKRS. Projekt në vlerë 150'000€, ku përfshihet ndërtimi i tribunave në stadiumin e qytetit.
- Rrjeti 3G nga IPKO Pa kosto. Instalimi i rrjetit 3G në Palestrën Sportive, në Qendrën e Kulturës dhe në Stadiumin e Qytetit.

- Financim nga Biblioteka Kombëtare dhe Zyra Amerikane, ku është bërë hapja e bibliotekës për herë të parë në shkollën profesionale "Bahri Haxha".
- Remzije Gjocaj i dhuroi Bibliotekës "Naim Frashëri" rreth 500 libra.
- Fatmire Duraku i dhuroi Bibliotekës "Naim Frashëri" 74 libra.
- Sabri Maxhuni i dhuroi Bibliotekës "Naim Frashëri" 22 libra.
- Brahim Avdyli i dhuroi Bibliotekës "Naim Frashëri" 4 libra.
- Thesari Kombëtar i Mërgatës Shqiptare në Suedi i dhuroi bibliotekës "Naim Frashëri" 3 libra.
- Abdyl Uka i dhuroi bibliotekës "Naim Frashëri" 3 libra.
- Funkcionalizimi i "Këshillit të Veprimit Rinor Lokal" U bënë zgjedhjet e reja në KVRL, u hartua Statuti dhe Plani i KVRL-së ku me vendim të Kryetarit të Komunës u bë edhe njohja ligjore e KVRL-së.

Gjeodezi, kadastër dhe pronë

Gjatë periudhës 01.01.2014-31.12.2014, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë kryer këto punë dhe detyra:

Nr. Rend.	LËNDËT E ARRITURA janar- dhjetor 2014	Gjithsej
1.	KËRKESAT E ARRITURA	7785
2	AKTVENDIME PËR BARTJE	913
3.	AKT. PËR KORRIGJIMIN E EMRAVE DHE MBIEMRAVE	83
4.	AKTVENDIME PËR REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	103
5.	AKTVENDIME PËR ÇREGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	54
6.	VËRTETIME-CERTIFIKATA	1718
7.	COPËTIMI-NDARJA FIZIKE	64
8.	CAKTIM I KUFIJVE	31
9.	EKSPERTIZA GJYQËSORE	21
10.	KOPJE TË PLANIT	651
11.	LISTA POSEDUESE	4820
12.	KËRKESA ZYRTARE TË NDRYSHME	86
13.	LISTA POSEDUESE DHE VËRTETIME PËR ASISTENCË SOCIALE	4947
14.	SHPRONËSIMET-UZURPIMET	24
15	IDENTIFIKIM PARCELE	65
16	KËRKESA NGA KOMPANITË PRIVATE	26
17	KËRKESA PËR AKP	16
18	LËNDËT NË PROCEDURË	108
19	KËRKESA DHE ANKESA TJERA	122

Për realizimin e të drejtave të ndihmave sociale, këtij drejtorati, për lëshimin e certifikatave mbi gjendjen pronësore i janë paraqitur **4947** kërkesa. Shërbimi i Drejtoratit për gjeodezi, kadastër dhe pronë pas

kontrollimit të evidencës, të gjitha palëve u ka lëshuar certifikatat mbi gjendjen pronësore, për arsye se të gjitha rastet kanë qenë duke marrë ndihma sociale dhe janë liruar nga pagesa e taksës komunale.

Gjatë vitit 2014, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka kryer shumë punë sipas detyrës zyrtare për nevoja të komunës në mbështetje të realizimit të shumë projekteve të realizuara në komunën tonë, si: udhëheqja e procedurave të shpronësimit, lirimi i pronave të uzurpuara etj.

Të gjitha projektet që i udhëheq Drejtoria për Urbanizëm dhe Drejtoria për Shërbime Publike janë të lidhura me bazën gjeodezike dhe pronësore ku në çdo projekt asistojnë zyrtarët e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër.

Integrime evropiane

Gjatë vitit 2014 Zyra për Integrim Evropian ka kontribuar në plotësimin e prioriteteve komunale që dalin nga “Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit” dhe “Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave”, me theks të veçantë në ri-integrimin e të kthyerve, monitorimin e organeve të administratës, integrimin e komunitetit RAE në sistemin arsimor, etj.

“Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave” - Të gjitha institucionet kanë marrë obligime, të cilat kanë dalë nga ky udhërrëfyes. Edhe pse udhërrëfyesi është publikuar në vitin 2012, sfidat që dalin nga ai ende nuk janë përmbytur, andaj edhe Komuna e Vushtrrisë ka vazhduar në plotësimin e obligimeve komunale, ku obligimi kryesor i cili kërkohet nga komunat është ri-integrimi i personave të riatdhesuar. Në këtë drejtim Zyra për Integrim Evropian në bashkëpunim me Zyrën për Komunitete dhe Kthim kanë dhënë kontributin e tyre, duke bashkëpunuar edhe me MPB-në, ku përmes Komisionit Komunal për Ri-integrimin e personave të riatdhesuar kanë mbështetur ri-integrimin e këtyre personave.

Në rastin e 9 Majit – “Ditës së Evropës”, është organizuar ekspozitë me piktura që ka pasur si mesazh integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian dhe kësaj që të gjitha pikturat kanë qenë në këtë frymë. Pjesëmarrës në këtë ekspozitë kanë qenë nxënësit e shkollave të Vushtrrisë, në ç’rast janë ndarë shpërblime për nxënësit që kanë ekspozuar pikturat më të mira.

Takimi i zyrtarëve komunal të integrimeve evropiane në MAPL, ku është prezantuar dhe diskutuar Plani i Veprimit Komunal për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit; Finalizimi i Indokatorëve në Planin e Veprimit Komunal për MSA 2014 dhe Obligimet e komunave bazuar në PVMSA 2014.

Raportim në MAPL për “Zbatimin e Legjislacionit të Kosovës sa i përket masave të përcaktuara në Udhërrëfyesin për Liberalizim të Vizave, Blloku 4/Të drejtat themelore lidhur me lirinë e lëvizjes”

Më 2 korrik – Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga GIZ me temën „Përkrahje e Procesit të Integritimit Evropian të Kosovës“ si dhe pjesëmarrja e rregullt në takimet e organizuara nga MAPL.

Njësia e Personelit

Janë kryer këto punë: procedimet lidhur me vlerësimet e nëpunëseve civil në Administratën komunale; përcjellja e trajnimeve për nëpunësit civil; zbatimi i procedurave të rekrutimit për të gjitha vendet e punës; përpunimi i të dhënave për nëpunësit e Administratës Komunale për çdo muaj dhe dërgimi i tyre në Departamentin e Administrimit të Shërbimit Civil-MAP; kontakte javore me IKAP-in për çështje të trajnimeve të nëpunësve; vizitat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës; përpilimi i të gjitha vendimeve dhe akteve tjera për

shërbyesit civil të komunës (pushimet vjetore, mjekësore dhe pushimet tjera sipas ligjit); përcjellja e disiplinës në punë; përgatitja e raportit mujor për Ministrinë e Administratës Publike mbi numrin e punëtorëve, strukturën kualifikuese, gjinore, etnike në Administratën komunale, si dhe punë tjera në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara me ligj.

Zyra për komunikim me publikun

Tani e disa vite Komuna e Vushtrrisë, ka krijuar një traditë të mirë të informimit dhe komunikimit me qytetarë, si dhe transparencës e llogaridhënies para qytetarëve.

Në vitin 2014 Zyra e Komunikimit me Publikun (ZKP) ka zgjeruar bashkëpunimin me partnerë ndërkombëtarë. Sikur edhe në vitet e kaluara, edhe këtë vit Komuna e Vushtrrisë - ZKP ka marrë vlerësime pozitive si nga institucionet qendrore MAPL ashtu edhe nga organizatat ndërkombëtare si USAID-I, OSBE dhe organizata joqeveritare kosovare që merren me monitorimin e pushtetit lokal.

Publikimi i vazhdueshëm i i dokumenteve dhe informatave të rëndësishme e që janë në interes të qytetarëve, ka ngritur transparencën e organeve komunale. Vetëm gjatë vitit 2014 janë 202 041 hapje në ueb-faqen komunale, ndërsa në ueb-faqen zyrtare janë publikuar gjithsej 152 lajme. Gjithashtu në rrjetin social, në faqen zyrtare të Facebook-u janë publikuar 239 postime, prej të cilave janë punuar 78 videomateriale. Nga 30 shtatori 2014 është hapur faqja zyrtare e komunës në facebook: Komuna Vushtrri-Faqja Zyrtare Organizatë qeveritare Fan Page, dhe gjatë gjithë vitit është bërë transmetimi në kohë reale i të gjitha mbledhjeve të Kuvendit Komunal, në radion lokale.

Transparenca

Këtë vit është shënuar një pjesëmarrje më e madhe e qytetarëve në diskutimet publike, propozimin e buxhetit, por edhe në takimet e Kryetarit të komunës me qytetarë, ku këta të fundit kanë diskutuar për investimet, por edhe kanë shprehur interesimin e tyre për përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve për jetë më të mirë.

Publikimi i akteve komunale

Në ueb-faqen zyrtare të komunës janë publikuar të gjitha vendimet aktet nënligjore – rregulloret, urdhëresat dhe procesverbalet e Kuvendit Komunal, si dhe të gjitha shpenzimet buxhetore.

Qasja në dokumente publike

Përmes zyrtarit për qasje në dokumente publike, janë administruar 15 kërkesa për qasje në dokumente publike, prej të cilave është lejuar qasje e plotë në 14 prej tyre, ndërkaq një kërkesë është bërë për një dokument të cilin nuk e posedon komuna. Prandaj për këtë është njoftuar me kohë parashtuesi i kërkesës.

Peticionet

Në vitin 2014 fillimisht Këshilli i drejtorëve i Komunës së Vushtrrisë e më pas edhe Kuvendi Komunal ka shqyrtuar dy peticione të qytetarëve lidhur e për të cilat iu ka dërguar përgjigje parashtuesve të peticioneve.

Përdorimi i gjuhëve

Komuna përmes një projekti të OSBE-së, ka angazhuar 15 zyrtarë në kurs intensiv, në mësimin dhe përforcimin e gjuhës serbe. Sfidë tjetër po ashtu mbetet zhvillimi i faqes zyrtare në gjuhën angleze.

Për shkak të përvojës, si komuna e parë që ka hartuar Strategjinë për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve në Proceset Vendimmarrëse, shefi i Zyrës për Komunikim me Publikun i Komunës së Vushtrrisë është angazhuar nga Departamenti për Demokratizim i OSBE-së si konsulent gjatë hartimit të Strategjisë dhe planit të Komunikimit në pesë Komuna të Kosovës që është mbështetur nga OSBE-ja.

Sekretaria e Kuvendit

Gjatë vitit 2014 Sekretaria e Kuvendit ka përgatitur dhe përcjellur ecurinë e punës së: Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë; Komitetit për Politikë dhe Financa; Komitetit për Komunitete; Komitetit Këshillëdhënës për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini; Komitetit Këshillëdhënës për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike; Komitetit Këshillëdhënës për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit; Komitetit Këshillëdhënës për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale; Komitetit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

Gjithashtu ka përgatitur thirrjet (ftesat), ka proceduar materialet e pikave të rendit të ditës; ka hartuar procesverbalet për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve obligative dhe këshillëdhënëse; ka proceduar të gjitha rekomandimet e komiteteve obligative dhe konsultative tek organet kompetente; ka adresuar edhe pyetjet e anëtarëve të kuvendit për drejtoritë përkatëse.

Gjatë vitit 2014 Sekretaria e Kuvendit ka materializuar këto akte: 72 Vendime, 5 Rregullore dhe Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës.

Ka përgatitur po ashtu dhe ka përcjellur ecurinë e punës për 11 mbledhje të rregullta dhe një të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, pastaj për 11 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa; për 11 mbledhje të Komitetit për Komunitete, si dhe për 18 mbledhje të mbajtura nga Komitetet Këshillëdhënëse.

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar në tërësi planin vjetor të miratuar nga Zyrtari kryesor administrativ. Menaxhmentit i janë dorëzuar 5 raporte finale, 4 raporte tremujore, si dhe 2 rishikimet për përcjellje të zbatimit të rekomandimeve ZKA-së dhe NJQHAB lidhur me Auditimet e Brendshme për aktivitetet e NJAB bazuar në nenin 14 pika 2.7 të Ligjit të Auditimit të Brendshëm.

Sipas dispozitave të Ligjit mbi Auditimin e Brendshëm aktual, është rishikuar dhe azhurnuar Plani strategjik 2014-2016, duke marrë për bazë faktorët e rrezikut, si dhe është përgatit edhe Plani vjetor 2015, për të cilin është dhënë pëlqimi dhe ndihmesa nga Komiteti i Auditimit, i cili është aprovuar nga ZKA-ja në afatet e parapara ligjore. NJAB në çdo gjashtëmuor sipas datave të planeve të veprimit ka përcjell zbatimin e rekomandimeve të vitit 2014 me qëllim të vlerësimit dhe zbatimit të tyre sipas udhëzimeve e doracakëve të AB në pajtim me standardet profesionale të vendosura nga NJQHAB-së. Pas rishikimit të rekomandimeve të dhëna të vitit 2014 e që janë gjithsej 12, janë zbatuar 5, ndërsa 5 janë në proces apo pjesërisht të zbatuara dhe 2 rekomandimet e pazbatuara janë të raportit final të prokurimit të lëshuara në dhjetor të vitit 2014, të cilat do të rishikohen me rishikimin e radhës.

Zyrtari kryesor administrativ pas dorëzimit të raporteve finale ka mbajtur takime të rregullta me NJAB dhe me drejtoritë e audituara me qëllim të dhënies së urdhëresave për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Komiteti i Auditimit funksionon, dhe për vlerësimin e raporteve të vitit 2014 ka mbajtur katër takime, duke respektuar Udhëzimin Administrativ nr. 11/10, kurse bazuar në raportin e fundit KA ka konstatuar se:

- NJAB ka rishikuar dosjet dhe ka bërë përcjelljen e rekomandimeve të NJAB dhe AP në ç'rast ka informuar ZKA-në për nivelin e zbatimit të rekomandimeve më dt. 18.12.2014 përmes formës elektronike.

- Bazuar në dokumentacionin përgjatë viti 2014 NJAB ka bërë një punë të çmuar me ndikim në përmirsimin e vazhdueshëm të KB-së.
- NJAB në tërësi e ka përmbush planin vjetor 2014.
- Ne gjithashtu kemi vërejtur një koordinim dhe vlerësim të punës në AB e cila është paraqitur edhe në opinionin e raportit AP nr. dok 22.24.1-2013-08 qershor 2014, duke përfshirë fusha me rrezik, të shoqëruara me gjetje dhe konstatime dhe rekomandime të vlefshme, të cilat kanë shpalosur dobësitë e KB-së të sistemeve kryesore financiare.

Angazhimet e NJAB kanë rezultuar me kryerjen edhe të këtyre punëve: sistemimin e dosjes së përhershme dhe të tanishme me të gjitha dokumentet e punës sipas fazave të auditimit me standardet e kërkuara për çdo auditim të kryer.

Zyra Ligjore

Udhëheqësi i Zyrës Ligjore - përfaqësuesi i autorizuar i komunës

Gjatë vitit për të cilin po raportojmë përfaqësuesi i autorizuar i komunës ka kryer këto punë dhe detyra të punës:

- Ka marrë pjesë në 132 seanca gjyqësore sipas ftesës së gjykatës;
- Ka ushtruar 1 padi dhe 3 përgjigje në padi;
- Ka ushtruar 8 ankesa, 7 kundërshtime, dhe 2 kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në prokurorin e shtetit;
- Ka ushtruar tri propozime për përmbarim, lidhur me të cilat ka arritur ujdi gjyqësore me debitorët dhe lëndët janë në procedurë të përmbarimit;
- Ka dhënë opinione dhe këshilla ligjore për organet e komunës dhe organet e administratës komunale;
- Ka bërë përgatitjen dhe analizimin e lëndëve sipas nevojës.

Zyrtari ligjor

Gjatë vitit për të cilin po raportojmë ka kryer punë dhe detyra të punës me sa vijon:

- Ka dhënë 22 rekomandime dhe opinione për çështje ligjore organeve të komunës dhe organeve të administratës komunale;
- Ka nxjerr 4 vendime në procedurë administrative, me të cilat është aprovuar kërkesa e palëve, lidhur me privatizimin e banesave;
- Ka hartuar dhe nënshkruar 4 kontrata lidhur me shitblerejn-privatizimin e banesave, për të cilat palët kanë pasur të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm;
- Ka nxjerr 2 vendime, me të cilat ka refuzuar kërkesat për privatizimin e banesave;
- Ka marrë pjesë në punën e komisioneve si: për vlerësimin, hartimin e draft rregulloreve dhe akteve tjera administrative dhe në punën e komisionit për ankesa lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Zyra Lokale e Komuniteteve

Zyra lokale e komuniteteve gjatë vitit raportues i ka kryer të gjitha punët që kanë të bëjnë me ofrimin e ndihmës pjestarëve të komuniteteve joshumicë në komunë, përkatësisht zgjidhjen e problemeve me të cilat janë ballafaquar. Puna dhe funksioni i kësaj zyreje është i lidhur ngusht dhe bashkëpunon me të gjitha institucionet komunale, duke filluar nga Kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive, zyrat dhe sektorët tjerë. Ky bashkëpunim ka qenë në nivel të knaqshëm për t'i përmbushur kërkesat dhe nevojat e komuniteteve joshumicë në komunë. Ky bashkëpunim është realizuar përmes një qasjeje konstruktive gjatë kontakteve, takimeve të shpeshta, gjegjësisht mbledhjeve në të cilat janë diskutuar çështje dhe probleme me interes për komunitetin joshumicë.

Disa zyrtarë të kësaj zyreje të komunitetit serb kanë marrë pjesë rregullisht në kursin për mësim të gjuhës shqipe. Në kuadër të ZLK-së janë kryer edhe punët rreth kthimit të qëndrueshëm dhe reintegrimit në pajtim me Planin për zbatimin e Strategjisë të Republikës së Kosovës për reintegrim të komuniteteve rom ashkali dhe egjiptas.

Gjatë kësaj periudhe në bashkëpunim me OSBE-në dhe këshillin e fshatit i përbërë nga komuniteti shqiptar si partner, është punuar në përmirësimin e kushteve dhe inkurajimin e 13 familjeve të

komunitetit serb nga fshati Vërrnicë për t'u kthyer në vendin e origjinës. Gjithashtu janë riatdhesuar gjithsej 38 persona, të cilët i plotësojnë kriteret për përfitim. Janë edhe tri familje të akomoduar, ndërsa në asistencë për ushqim dhe gjëra higjienike 7 familje, të cilave u ndimohet 6+6 muaj pas riatdhesimit, gjë që numri i këtyre familjeve varion sepse ka që dalin nga skema e ndihmave, po ashtu edhe familje që hyjnë në skemë nga fillimi, e që kjo gjë varet nga fluksi i të kthyerve. Brenda kësaj periudhe janë marrë nga bordi ekzekutiv për riintegrimin e personave të riatdhesuar 8 vendime për përkrahjen e bizneseve në vlerë deri në 2000 €, gjë që do të thotë se bazuar me numrin e të kthyerve gati çdo person që ka hartuar plan-biznesin dhe ka aplikuar është edhe përfitues i kësaj ndihme. Së bashku me Zyrën e punësimit janë trajnuar në punë 23 persona të riatdhesuar ku prej tyre janë 14 femra, projekt ky i financuar nga UNDP në bashkëpunim me MPB, ZP dhe ZKKK, përkatësisht koordinatori komunal për kthim & riatdhesim.

Nga Serbia ka qenë një rast i kthimit në fshatin Prelluzhe të cilin rast së bashku me DRC (organizatë daneze) si partnere e kemi organizuar kthimin në shtëpinë e asaj familjeje dhe po ashtu është ndihmuar me gjëra ushqimore dhe higjienike.

ZLK gjatë punës ka realizuar një bashkëpunim të mirë edhe me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, Policinë e Kosovës, KFOR-in, UNMIK-un, OSBE-në, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, që i ka kontribuar në masë të konsiderueshme avancimit të pozitës së komuniteteve joshumicë në komunë.

Këshilli për Siguri në Bashkësi

Me udhëzimin Administrativ të MPB-së dhe MAPL-së është paraparë që Kryetari i komunës t'i paraqesë Kuvendit raport për punën e këtij këshilli. Siç dihet, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, ka rol këshillues në çështjet e sigurisë në bashkësi, me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve. Ky këshill gjithashtu ka për qëllim rritjen e vetëdijësisë të qytetarëve lidhur me sjelljet e dhunshme në komunitet, si dhe ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve, nëpërmjet të ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në bashkësi.

KKSB, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë të tij, bashkëpunon me Policinë e Kosovës dhe institucionet qendrore, të cilat merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi, si dhe ndërtimin e besimit për jetë të qetë e të sigurt të të gjitha komuniteteve në meset ku ata jetojnë. Ky këshill në vitin 2014 ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje të rregullta. Gjithashtu me udhëzimin e ri administrativ, KKSB mban mbledhje të rregullta çdo 2 muaj.

Mbledhjet në këtë këshill janë mbajtur në gjuhët zyrtare në komunë, duke qenë se përbërja e tij është shumë etnike. Mbledhjet e KKSB-së kanë qenë të hapura, ato i kanë përcjell përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së, etj. Në këto mbledhje pjesëmarrja e anëtarëve të KKSB-së ka qenë e kënaqshme, dhe secili nga anëtarët e këshillit ka diskutuar për çështjet dhe problemet për të cilat ka përfaqësuar në këtë këshill, si dhe ka dhënë kontributin në zgjidhjen e problemeve të caktuara.

